



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.1104 Prot.

Tiranë, më 28 .07 . 2022

**V E N D I M**

**Nr.153 , Datë 28 .07. 2022**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>2</sup>, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 146 Regj, datë 03.08.2021, paraqitur nga ankuesi E.A (*në vijim ankuesi*), kundër Shërbimit Informativ të Shtetit (*në vijim SHISH*) me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, “*gjendjes shoqërore*”, “*përkatësisë prindërore*”, “*përkatësisë në një grup të veçantë*” dhe “*çdo shkak tjetër*”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesi E.A, pretendon se është diskriminuar nga ana e SHISH për disa shkaqe dhe konkretisht:

*Në lidhje me shkakun e gjendjes arsimore*, ankuesi pretendon se megjithëse ka kryer arsimin e lartë dhe kursin bazë të inspektorit të Linjës Informativo-Operative në SHISH që prej datës 04.04.2014, ende nuk është titulluar inspektor, me gjithë kërkesat e tij të përsëritura. Zakonisht, të gjithë punonjësit e SHISH titullohen inspektorë menjëherë pas përfundimit të këtij kursi.

*Në lidhje me shkakun e gjendjes shoqërore (lidhur me prejardhjen ose origjinën partiake)*, ankuesi pretendon se, para se të pranohej në SHISH ka bërë deklaratën e departizimit, si ish anëtar i PS. Pavarësisht se ky fakt nuk i është përmendur shprehimisht lidhur me vlerësimet e punës apo rastet e procedimeve disiplinore, mendon se një gjë e tillë ka ndikuar në vendimarrjen e drejtuesve të

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

SHISH, të emëruar nga Drejtori i Shërbimit z. Visho ose z. Helidon Bendo (të cilët perceptohen si me prejardhje të “djathtë”). Ankuesi shpjegon se, veçanërisht në kushtet e SHISH, një motiv i tillë është i vështirë të vërtetohet, pasi ligji e ndalon, ndërsa punonjësit dhe institucioni janë të kualifikuar që në veprimtarinë e tyre të mos i referohen ose të mos i përmendin shprehimisht termat partiakë. Mirëpo kjo është zëvendësuar me nënkuptimin e një lloj luajaliteti ose besnikërie ndaj Drejtorit të SHISH, deri në masën që vartësit mund të funksionojnë si instrumente gjatë vendimarrjes, pavarësisht fakteve.

*Në lidhje me shkakun e përkatësisë prindërore*, ankuesi shprehet se, gjendja e tij shoqërore si më sipër është shpjeguar, mund të jetë rënduar më tepër, për shkak të përkatësisë prindërore. Babai i tij (shtetasi B.A) ka kryer ish Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (specialiteti sigurim) dhe ka punuar rreth 10 vite në këtë profesion, deri në ndërrimin e sistemit. Gjatë viteve 1991-1993, babai i ankuesit ka punuar në polici, ndërsa gjatë periudhës 1998 e deri aktualisht, pra 23 vjet, ai ka punuar në SHISH. Gjatë viteve 2010-2012 babai i ankuesit ka qenë këshilltar i Drejtorit të Shërbimit (z. Bahri Shaqiri) dhe është shkarkuar menjëherë nga drejtori pasues z. Visho Ajazi Lika, duke e caktuar inspektor. Ulja e konsiderueshme në detyrë (3-4 shkallë më poshtë) dhe bllokimi i karrierës deri më sot, nuk përputhet me shkallën e përgatitjes dhe kualifikimit, por mund të lidhet me përkatësinë dhe paragjykimet nga dy titullarët e fundit, ose me influencat e tyre përgjatë linjave të vartësisë. Sipas ankuesit instrumentat bllokues ndaj babait të tij ngjasojnë me ato të përdorura ndaj tij, përmes spekulimeve me “vendet e lira”, “vlerësimet e punës” dhe “masat disiplinore”, si mjeti i fundit, sapo ka shfaqur ndonjë kërkesë ose pretendim.

Ankuesi pretendon se shkak tjetër sipas tij është ndihma e ofruar nga babai në lidhje me ankesat që ankuesi ka bërë. Acarimi ka ardhur edhe si pasojë e fakteve dhe argumentave të paraqitura në ankesat e tij, duke bërë që hakmarrja ndaj tij të projektohet edhe si goditje ndaj babait të tij. Ankuesi deklaron se, ndaj babait të tij është dhënë masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim” duke patur si prapavijë pikërisht mbështetjen ndaj ankuesit.

*Në lidhje me shkakun e përkatësisë në një grup të veçantë*, ankuesi deklaron se ai bën pjesë në kategorinë e punonjësve të SHISH që janë pranuar fillimisht si ndihmës inspektorë, ndërsa kursin bazë e kanë kryer pas emërimit si ndihmës inspektor. Kjo kategori punonjësish është mjaft e vogël krahasuar me kursantët e pranuar rishtas në kursin bazë të SHISH. Sipas ankuesit, në SHISH është krijuar precedenti, që emërimi si inspektor ndonjëherë ka zgjatur edhe me vite pas përfundimit të kursit bazë, ndërsa kursantët e pranuar rishtaz janë emëruar direkt.

Ankuesi shpjegon gjithashtu se, rasti i tij bën pjesë në kategorinë e punonjësve të SHISH, që megjithëse janë pranuar fillimisht si ndihmës inspektor, nuk janë përfshirë në kursin bazë të shkurtuar, enkas për këtë kategori punonjësish, por janë pranuar në kursin bazë të plotë, çelur posaçërisht për kursantët e pranuar rishtaz në SHISH, të cilët emërohen inspektorë menjëherë pas përfundimit të këtij kursi. Me përfaqësi nëse në kurs morën pjesë 60 kursantë, 58 prej tyre ishin kursantë të pranuar rishtaz, që u emëruan inspektorë menjëherë pas përfundimit të kursit, ndërsa nga dy të tjerët që ishin pranuar më herët si ndihmës inspektor në SHISH, njëri prej tyre e merr emërimin ndërsa tjetri, pra ankuesi, nuk e ka marrë emërimin si inspektor. Sipas ankuesit, kur rasti

i tij (me kursin e plotë) krahasohet me punonjësit që kanë kryer kursin e shkurtuar më herët, eprorët kanë preferuar punonjësit më të vjetër në punë, ndërsa kur rasti i ankuesit krahasohet me kursantët e tjerë me kursin e plotë, eprorët kanë preferuar kandidatët e pranuar rishtaz që vitin e parë të punës e kanë periudhë prove.

Sipas ankuesit mos emërimi i tij si inspektor është diskriminues, jo vetëm në raport me emërimin inspektorë të kursantëve me të cilët ka përfunduar kursin e plotë, por ky diskriminim ka vazhduar të përsëritet periodikisht edhe më pas, në raport me çdo valë emërimesh të punonjësve dhe kursantëve që kanë përfunduar kurset bazë të shkurtra dhe të plota, në vitet pasuese, nga mesi i 2014 deri në fund të 2019.

Ankuesi ngre shqerësimin se në kushtet e shërbimeve sekrete spekulohet shumë me përmbajtjet, formatet dhe nivelet e ndryshme të klasifikimit, por sipas tij, SHISH i ka mundësitë që të ofrojë përmbajtjen e saktë, duke modifikuar inicialet e identiteteve apo funksionet, por pa prekur të vërtetën.

Ankuesi shpjegon se, në datën 24.04.2012 ka dalë urdhri i Drejtorit të SHISH për pranimin e tij në SHISH dhe fillimin e punës si ndihmës inspektor pranë Drejtorisë X<sup>3</sup>. Në këtë rast emërimi është bërë pa konkurim, sipas përcaktimeve në ligjin “Për statusin e punonjësit të SHISH” dhe Rregulloren e Brendshme. Ndërsa pranimet me konkurim bëhen për kandidatët që planifikohen të futen menjëherë në kursin (e plotë) bazë 6 mujor të SHISH, ku me përfundimin e tij emërohen direkt si inspektor të LIO (Linja informative-operative). Pra, ky lloj pranimi është një “pranim në kursin bazë të inspektorit të LIO në SHISH”, ndërsa kursi është i vetmi i këtij lloji, ku me përfundimin e tij kursanti emërohet direkt si inspektor pa kaluar (asnjëherë) me ndonjë fazë pararendëse si ndihmës inspektor.

Në pranimet pa konkurim, pranimi mund të jetë për çfarëdo niveli, për ndihmës inspektor, inspektor ose edhe për ndonjë nivel drejtues. Ky lloj pranimi nuk kushtëzohet me kryerjen qysh në fillim të kursit bazë në Institutin e SHISH. Kjo kategori punonjësish iu nënshtrohet specializimeve të shkurtra (disa ditore, deri në 6 javë) në përshtatje me vendin e punës, zakonisht pranë njësive ku janë emëruar. Ndërsa me lindjen e nevojave për inspektorë të ILO dhe pas plotësimit të numrit të mjaftueshëm për një klasë mësimore, në Institutin e SHISH (qendrën e trajnimit) mund të çelet kursi bazë (i shkurtuar) për inspektorë të ILO në SHISH, me punonjës të brendshëm, që zgjat rreth 3 muaj e gjysëm.

Kursi (i shkurtuar) 3.5 mujor konsiderohet i barazvlefshëm me kursin (e plotë) 6 mujor, pasi në të parin presupozohet që punonjësit janë përditësuar në punë e sipër me njohuritë në specialitetin që kanë ushtruar deri aktualisht. Vendimi për çeljen e këtij kursi (njësoj si për kursin e plotë) rrjedh nga studimi i nevojave për burime njerëzore për inspektorë të ILO, duke përfshirë numrin e vendeve që mbahen aktualisht nga inspektorët pa kursin bazë, si dhe numrin e vendeve të tjera, tashmë vakante, ose që priten të lirohen apo krijohen në një plan afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

---

<sup>3</sup> Referencat për strukturat e SHISH janë paraqitur të anonimizuara.

Në datën 01.03.2013, ankuesi ka mësuar se pranë Institutit të SHISH do të fillonte kursi bazë, i shkurtuar (3.5 mujor), për inspektor të ILO-s. Ankuesi ka paraqitur kërkesën për të filluar kursin, por fillimisht kërkesa e tij nuk ishte pranuar nga Drejtori i SHISH “për shkak të veçorive të Drejtorisë X”, sikurse ankuesi ishte informuar nga eprorët. Nëpërmjet babit të tij, ankuesi ka bërë një kërkesë të dytë në datën 27.02.2013. Në këtë kërkesë, sipas ankuesit, Drejtori i SHISH kishte lënë shënimin: “ z. A, së pari: ne sapo mbaruam së bëri ristrukturimin e agjencisë. Së dyti: djali juaj mundet të aplikojë për kursin e plotë dhe pas tij të shohim mundësinë e emërimit në sektorin operativ.” Mbi bazën e këtij premtimi, ankuesi ka paraqitur kërkesën e tretë në datën 27.08.2013 dhe në vijim ai kreu kursin e plotë (dmth, jo të shkurtuar), së bashku me kursantët e tjerë (të ardhur rishtaz nga jeta civile, që ishin pranuar me konkurim), nga data 16.09.2013-04.04.2014. Në përfundim të kursit të plotë, ankuesi është pajisur me certifikatë, njësoj si edhe për të gjithë kursantët e tjerë, me formulimin standard, sipas të cilit certifikata jepet: “.....për kryerjen e Kursit Bazë të “Inspektorit të Linjës Informative.....”.

Duke mos u përfshirë në kursin e shkurtuar, në rastin e ankuesit ishte krijuar një precedent tjetër i ri, pasi ndodhte për herë të parë, që dy punonjës në marrëdhënie pune me SHISH (ankuesi dhe një ndihmës inspektor tjetër nga Drejtoria X) do të kryenin kursin e plotë. Ndërkohë, që të dy kishin kryer më herët edhe specializimin dy mujor sipas vendit të punës – si ndihmës inspektor, pranë njësisë (gjatë periudhës tetor – dhjetor 2012). Me përfundimin e kursit të plotë, më 04.04.2014, së bashku me kursantët e tjerë të pranuar rishtaz nga jeta civile (gati 60 persona), të gjithë u emëruan inspektorë, duke përfshirë edhe kolegun nga Drejtoria X, i cili ishte në të njëjtat kushte me ankuesin, ndërsa ankuesi nuk u emërua inspektor, pavarësisht përfundimit të kursit me rezultate të larta. Për emërimin e ankuesit si inspektor i LIO në SHISH mbeteshin dy alternativa: 1) emërimi si inspektor i LIO, pas krijimit të ndonjë vendi vakant pranë Drejtorisë X. Për këtë ankuesit i ishte thënë që duhet të priste radhën pas emërimit të kolegëve që e kishin kryer kursin e shkurtuar më herët, pavarësisht se ai kishte kryer kursin e plotë; 2) emërimi inspektor në ndonjë sektor tjetër të LIO, jashtë Drejtorisë X. Në të dy rastet e drejta e propozimit për titullimin si inspektor, i mbetej drejtorit të Drejtorisë X ose drejtorit të njësisë së burimeve njerëzore, bashkëlidhur me mendimin e drejtorit të Drejtorisë X dhe anasjelltas.

Në këtë mënyrë, mosemërimi inspektor i LIO pranë Drejtorisë X, veçanërisht gjatë viteve 2014-2017, është justifikuar me qënien në radhë pas 2-3 kolegëve të tjerë që e kishin kryer kursin e shkurtuar më herët, pavarësisht se ndërkohë nuk kanë munguar emërimet si inspektor pa kursin bazë apo me kursin bazë të kryer më pas. Mosemërimi inspektor i ndihmës inspektorëve që e kanë kryer kursin e shkurtuar më herët është diskriminues në krahasim me emërimin inspektorë të atyre që e kanë kryer kursin e shkurtuar më vonë ose që nuk e kanë kryer fare atë. Është diskriminues mosemërimi inspektor i punonjësve që kanë kryer kursin e plotë, siç është rasti i ankuesit, në krahasim me emërimin inspektor të kursantëve nga i njëjti kurs, që janë pranuar rishtaz në Shërbim.

Ndërsa mosemërimi inspektor në njësitë e tjera të LIO, mbetet në përgjegjësinë e Drejtorisë së që merret me burimet njerëzore, e cila ka shkelur në mënyrë të përsëritur, të drejtën e ankuesit për t’u emëruar inspektor, në çdo rast që ka identifikuar ndonjë vend vakant, si dhe çdo gjashtë muaj apo

çdo një vit, sa herë që ka planifikuar kurse bazë (të plotë apo të shkurtuar) për inspektorë të ILO, në funksion të mbulimit të vendeve vakante që krijohen ose pritet të lirohen periodikisht. Mos emërimi inspektor, është diskriminues jo vetëm në raport me emërimin e kursantëve me të cilët përfundoi kursin e plotë, por ky diskriminim ka vazhduar të përsëritet periodikisht edhe më pas, në raport me çdo valë emërimesh të punonjësve dhe kursantëve, që kanë përfunduar kurset bazë (të shkurtuara dhe të plota), në vitet pasuese, nga mesi i 2014 deri në fund të 2019.

Ankuesi shpjegon se, dyshimet e para për këtë trajtim diskriminues ka filluar t'i kristalizojë nga fundi i vitit 2017 dhe fillimi i 2018. Deri në vitin 2017, kërkesat për t'u emëruar inspektor kanë qenë të përsëritura çdo vit, por kanë qenë me gojë, duke u paraqitur personalisht te drejtuesit e njësisë. Në datën 11.06.2018, ankuesi ka bërë kërkesë me shkrim drejtuar drejtorit të drejtorisë që merret me burimet njerëzore, ku parashtronte mundësinë e emërimit të tij si inspektor në një vend pune (konkret) pranë Drejtorisë X që pritej të lirohej pas daljes në pension të një kolegu. Mosdakortësia nga drejtuesi i Drejtorisë X, për emërimin e ankuesit, u pasua me përpjekjet për të ulur nivelin e vlerësimit të punës në dhjetor 2018. Në datën 31.12.2018 ankuesi ka parqitur ankesë drejtuar drejtorit të Drejtorisë X mbi vlerësimin e punës për vitin 2018, ankesë e cila u mor parasysht dhe u bë ndryshimi nga ana e eprorit direkt nga “mjaftueshëm” në “mirë”.

Korrigjimi i vlerësimit të punës nga “mjaftueshëm” në “mirë” (sipas ankuesit duhet të ishte “shumë mirë”), sipas ankuesit, solli incidentin e datës 09.01.2019, nën drejtimin dhe nxitjen hakmarrëse të shefit të seksionit. Në lidhje me këtë incident ankuesi ka dërguar informacionin për Drejtorin e SHISH, ku kërkon që të lëvizë në një sektor tjetër për të shmangur varësinë nga ky seksion si dhe për shkeje të përsëritura nga shefi i seksionit. Për herë të parë ankuesi deklaroi se shprehte rezervat e tij për trajtimin që i bëhej, duke mos i mundësuar emërimin si inspektor.

Gjatë periudhës shkurt – prill 2019, nga SHISH, pati disa inspektime dhe kontrole të iniciuara me këtë rast. Duke parë që problemet po mbylleshin pa gjetur zgjidhje, në datën 23.04.2019 ankuesi i është drejtuar sërish Drejtorit të SHISH, duke i parashtruar kërkesën e drejtpërdrejtë për emërimin e tij si inspektor në një vend pune tjetër (konkret), për të cilin kishte mësuar se lirohej pranë Drejtorisë X. Sipas ankuesit, pas kësaj ankese, drejtuesit e Drejtorisë X shfrytëzuan një rast “me fletë kampi” gjatë periudhës 1-10 korrik 2019 duke marrë ndaj ankuesit masë disiplinore “vërejtje me paralajmërim” në datën 25.07.2019. Rasti ka të bëjë me një fletë kampi në Filialin e SHISH, Himarë. Ankuesi shpjegon se kishte rakorduar me eprorët për lejen e zakonshme 01-15 korrik 2019, pasi e kishte më të lehtë për të siguruar fletën e kampit në Filialin e SHISH në Himarë, të cilët sipas tij ishin dakort, pasi edhe pesë vitet e kaluara, me dijeninë e tyre ankuesi ka qenë po në të njëjtin vend. Pasi ka siguruar fletën e kampit, ankuesi i ka njoftuar eprorët 2-3 ditë përpara se në datat 01-10 korrik do të ishte në filialin e SHISH në Himarë, të cilët ishin dakort. Dy-tre ditë pasi ankuesi kishte shkuar në filialin e SHISH në Himarë, është njoftuar nga ana e Drejtorisë X se duhej të kthehej pasi nuk lejohej. Fleta e kampit ishte lëshuar në emrin e babait të ankuesit, i cili u thirr po këto ditë nga Drejtori i Departamentit. Pavarësisht kësaj, ankuesi deklaroi se nuk është larguar nga Filiali i SHISH në Himarë.

Disa ditë pas kthimit nga leja e zakonshme ankuesi është njohur me urdhrin nr. 520/3, datë 25.07.2019 për dhënie mase disiplinore “vërejtje me paralajmërim me motivacionin “shkelje e rregullave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për ruajtjen e sekretit shtetëror në SHISH, kur nuk përbën vepër penale”. Ankuesi pretendon se pika 5, e nenit 30 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë X, nuk ka të bëjë me rregullat për ruajtjen e sekretit. Ndalesa sipas kësaj pike lidhet vetëm me rastin gjatë kryerjes së procesit të mbikëqyrjes së fshehtë fizike, ndërsa ankuesi ishte me pushime, me të drejtë frekuentimi filialin në fjalë.

Në datën 04.08.2019, ankuesi ka paraqitur kërkesë ankimore në Komisionin disiplinor të SHISH, lidhur me masën disiplinore, duke pretenduar se nuk ka patur shkelje nga ana e tij dhe se ka patur raste të tjera të ngjashme të punonjësve që nuk janë konsideruar shkelje. Në datën 15.08.2019, ankuesi është thirrur para Komisionit Disiplinor për të shqyrtuar ankesën e paraqitur. Në datën 16.08.2019, Komisioni Disiplinor i ka njoftuar ankuesit se do t’i propozonte drejtorit të SHISH lënien e masës në fuqi, pa asnjë shpjegim tjetër.

Në datën 27.08.2019, ankuesi ka paraqitur kundërshtimin administrativ drejtuar Drejtorit të SHISH, kundërshtim i cili i është bërë me dije edhe Inspektorit të Përgjithshëm të Kryeministrit në SHISH. Ankuesi ka parashtruar në ankimin e tij se, problematika e fletës së kampit nga eprorët në Drejtorinë X ishte intrige dashkeqe dhe e paramenduar, se vërejtjet ndaj tij ishin tendencioze dhe se ishin sajuar fakte dhe rretana të pavërteta dhe të sforcuara që vinin menjëherë pas kërkesës së tij të datës 23.04.2019, për t’u titulluar inspektor. Më tej ankuesi ka pretenduar se rasti i tij nuk kishte të bënte me ngritjen në detyrë, por me marrëdhëniet juridike të kursantit në SHISH të cilat zgjidheshin me emerim në detyrë dhe se sa herë ishin krijuar vende të lira pune si inspektor në to ishin titulluar kolegë të tjerë shpesh në kushte më pak të favorshme se të tijat. Ankuesi ka pretenduar edhe për shkelje procedurale nga ana e Komisionit të Disiplinës.

Sipas ankuesit pas kundërshtimit administrativ të paraqitur prej tij, gjatë muajit shtator 2019 u kryen disa inspektime e kontrole nga Drejtori i SHISH, gjatë të cilave është pyetur edhe ankuesi në lidhje me problematikën, por nuk i është dhënë asnjë vlerësim me shkrim lidhur me pretendimet e tij. Sipas ankuesit pati vetëm dy reagime:

Më datë 30.09.2019 i është komunikuar me urdhër të Drejtorit të SHISH, emërimi si ndihmës inspektor, roje pranë Drejtorisë Y (roje te porta e jashtme me murin rrethues të SHISH), ky klasa më poshtë pozicionit të mëparshëm si ndihmës inspektor në Drejtorinë X.

Më datë 01.10.2019, babait të ankuesit shtetasit B.A (inspektor në SHISH) i komunikohet urdhri nr. 67, datë 01.10.2019 për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim” me motivacionin “shpërdorim i të drejtave dhe privilegjeve, duke përfutur padrejtësisht nga statusi i punonjësit të Shërbimit”, që lidhet me fletën e kampit të përdorur prej ankuesit, por të lëshuar në emrin e babait të tij.

Disa ditë pas transferimit në detyrën e re, ankuesi në datën 10.10.2019 është thirrur nga Drejtoria që merret me burimet njerëzore, ku është njohur me vlerësimin e punës në pozicionin e mëparshëm. Vlerësimi i punës ishte në nivelin “jo mjaftueshëm”.

Ankuesi ka paraqitur në datën 14.10.2019 në adresë të Drejtorit të SHISH një ankesë nëpërmjet të cilës kërkonte rishikimin e urdhrin të emërimit në detyrën e re dhe ndryshimin e vlerësimit të punës.

Një ditë më pas në 15.10.2019, babai i ankuesit paraqiti ankesë ndaj masës disiplinore që ishte marrë ndaj tij, lidhur me fletën e kampit të përdorur nga ankuesi. Në datën 21.10.2019 babai i ankuesit është njohur me vendimin e Komisionit Disiplinor, që i propozonte Drejtorit të SHISH lënien në fuqi të masës disiplinore dhe në datën 28.10.2019 është njohur zyrtarisht nga Komisioni Disiplinor me vendimin e Drejtorit të SHISH për miratimin e propozimit të Komisionit Disiplinor, lidhur me masën. Babai i ankuesit nuk e ka kundërshtuar masën në gjykatë.

Në datën 21.11.2019, ankuesi deklaroi se babai i tij ka zhvilluar një takim me Drejtorin e Kabinetit, ku i ka komunikuar këtij të fundit se nuk do ta ankimonte masën disiplinore në gjykatë, ndërsa i kërkoi që t'i përcillte Drejtorit të SHISH, lutjen për emërimin e ankuesit si inspektor në Drejtorinë e SHISH në Tiranë.

Në datën 27.11.2019, ankuesi deklaroi se është njoftuar për urdhrin nr. 414/1 prot., datë 22.11.2019 për dhënien e masës disiplinore “vërejtje me shkrim” për shkelje të disiplinës formale lidhur me mosrespektimin e manualit të Shërbimit.

Në datën 11.12.2019, ankuesi ka paraqitur ankesën e tij në Komisionin e Disiplinës, duke kundërshtuar se tre rastet për tërheqje vëmendje nga inspektorët e zyrës së informacionit (te godina qendrore) nuk qendronin dhe konkretisht: - Në një rast ankuesit i është tërhequr vëmendja në lidhje me ngjyrën e këmishës, e cila nuk ishte e bardhë. Sipas ankuesit në Rregullore nuk parashikohet ngjyra e këmishës, ndërsa inspektori që i kishte tërhequr vëmendjen e kishte vetë këmishën ngjyrë blu; - Në rastin e dytë kur i është tërhequr vëmendja nga inspektori ka patur të bëjë me ngjyrën e pantallonave, pasi ngjyra e pantallonave të ankuesit nuk ishte e zezë. Ankuesi pretendon se edhe në këtë rast Rregullorja nuk parashikon ndonjë ngjyrë konkrete për pantallonat; - Në rastin e tretë kur ankuesit i është tërhequr vëmendja, ky i fundit shpjegon se është pretenduar nga inspektori se nuk kishte patur qëndrim korrekt në vend-roje, pa specifikuar ndonjë gjë konkrete, por se shërbimi ishte kryer në përgjithësi mirë.

Në datën 19.12.2019 është zhvilluar mbledhja e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e ankesës, ndërsa në datën 23.12.2019 ankuesi deklaroi se është njohur me vendimin e Komisionit të Disiplinës se do t'i propozonte Drejtorit të SHISH lënien në fuqi të masës disiplinore “vërejtje me shkrim” si dhe lirin e ankuesit nga Shërbimi. Në datë 27.12.2019, ankuesi i ka paraqitur Drejtorit të SHISH kundërshtimin administrativ ndaj propozimit të Komisionit. Në vijim ka kalë urdhri i Drejtorit të SHISH nr.25-627, datë 30.12.2019, për ndryshimin e masës disiplinore të dhënë me urdhrin nr.414/1, datë 22.11.2019 dhe dhënien e masës disiplinore “përfshirje nga shërbimi” me motivacionin “Për shkelje të detyrave të përcaktuara në ligjin nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”. Tek ky urdhër tërheq vëmendjen se Drejtori i SHISH ka ndryshuar termin e përdorur në propozimin e Komisionit të Disiplinës nga “lirim nga shërbimi” në “përfshirje nga shërbimi” dhe kjo me sa duket ka ndodhur pasi në ligjin për Statusin “lirimi nga shërbimi nuk parashikohet si masë ndëshkimore”. Gjithashtu në urdhrin e Drejtorit të

SHISH motivacioni i përjashtimit jepet i përgjithshëm, pa përkatuar pikën konkrete që pretendohet se është shkelur dhe nuk ka asnjë parashikim që të referojë për të drejtën e padisë në gjykatë.

Me shkresën nr.1865, datë 31.12.2019 të Drejtorit të SHISH, ankuesit i është kthyer përgjigje kundërshtimit administrativ që ai kishte bërë ndaj propozimit të Komisionit Disiplinor. Me këtë shkresë ankuesit i është komunikuar se kundërshtimi administrativ ndaj propozimit të Komisionit Disiplinor nuk gjente mbështetje ligjore dhe se ankuesi i kishte shteruar të gjitha hallkat administrative të ankimit.

Në datën 22.01.2020, ankuesi ka paraqitur ankim kundër përjashtimit nga Shërbimi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së urdhrit nr.25-627, datë 30.12.2019 dhe rikthimin e tij në SHISH. Në këtë ankim ankuesi kundërshton bazueshmërinë e masës disiplinore “vërejtje me shkrim”. Në lidhje me “përjashtimin nga Shërbimi”, ankuesi pretendon se vjen në kundërshtim me nenin 54 të ligjit për Statusin, pasi shkelja e pretenduar do duhej të ishte e përafërt për nga rëndësia me rastin e parashikuar nga pika 1 të këtij neni dhe procedimi do duhet të niste nga të dhëna ose indicie për një vepër penale të mundshme, pavarësisht nëse procesi do fillonte me ndjekje penale apo me procedim disiplinor nga ndonjë inspektim i brendshëm.

Në përgjigje të ankimit të sipërcituar, ankuesit i është kthyer përgjigje me shkresën nr.18/1 prot., datë 4.2.2020, të Drejtorit të SHISH. Në këtë kthim përgjigje theksohet ndër të tjera se, përjashtimi i ankuesit nga Shërbimi nuk bazohet në nenin 54 të ligjit për Statusin, me pretendimin se nocioni i përjashtimit i përdorur në nenin 54 nuk është atribut i ushtrimit të kompetencës së Drejtorit të Shërbimit, por është detyrim bazuar në vendimin e gjykatës të formës së prerë me heqje lirie për një krim të kryer me dashje. Në përgjigje theksohet se përjashtimi i ankuesit nga SHISH ka ardhur si rezultat i masës disiplinore “përjashtim nga shërbimi” dhe ka si bazë ligjore nenin 47/dh. Ankuesi pretendon se argumentat e parashtruara nuk qendrojnë, pasi pika 2 e nenit 54 të ligjit për Statusin nuk përfshin rastet e përjashtimit nga Shërbimi për shkak të vendimit të gjykatës (pika 1 e nenit 54), por rastet e tjera sipas nenit 47/dh, ku ka kuptim ankesa te Drejtori i SHISH lidhur me përjashtimin nga SHISH. Pas vendimit përfundimtar nga Drejtori i SHISH (mbi përjashtimin nga SHISH) vjen radha për të drejtën e padisë në gjykatë. Mirëpo tek urdhi i Drejtorit të SHISH për ndryshimin e masës nr.25-627 datë 30.12.2019 nuk përmendet e drejta e ankimit, te Komisioni Disiplinor, Drejtori i SHISH apo në Gjykatë.

Ankuesi shpjegon se, kërkesat me shkrim ndaj Drejtuesit të SHISH për t’u emëruar inspektor i LIO në SHISH kanë vijuar në mënyrë të përsëritur, me kundërshtimin administrativ datë 27.08.2019, me kërkesën ankimore 14.10.2019, me takimin e babait të ankuesit me Dr.Kabinetit në datë 21.11.2019, ndërsa në ankesën pas lirimit në datë 22.01.2020 ankuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e urdhrit të lirimit dhe rikthimin në SHISH.

Rezervat e tij për diskriminim ankuesi i ka shfaqur për herë të parë me shkrim në informacionin për Drejtorin e SHISH në janar 2019, pastaj kanë vijuar në kundërshtimin administrativ drejtuar drejtorit të SHISH datë 27.08.2019, në të cilin i është referuar specifikisht ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, kërkesën ankimore Drejtorit të SHISH datë 14.10.2019, por nuk kanë patur efekt. Ndërsa për sa i përket fakteve diskriminuese, ankuesi



shprehet se, ato kanë filluar të përshkallëzohen menjëherë pas kërkesave të tij me shkrim për t'u emëruar inspektor, duke përfshirë periudhën nga kërkesa e parë me shkrim datë 11.06.2018 deri në momentin e lirimit, datë 30.12.2019. Vetëm 3 muaj pas kërkesës së dytë me shkrim (datë 23.04.2019) në korrik 2019 ndaj ankuesit është dhënë masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Pas ankimit datë 04.08.2019 dhe kundërshtimit administrativ datë 27.08.2019, lidhur me këtë vërejtje, më datë 30.09.2019 pasoi urdhri i shkarkimit si ndihmës inspektor dhe kalimi roje, pa motivacion, si dhe në datë 01.10.2019 masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim” ndaj babait të ankuesit (lidhur me asistencën në ankesat e paraqitura nga ankuesi). Pas kërkesës ankimore të datës 14.10.2019, vetëm një muaj më pas, ankuesit i është dhënë masa e dytë “vërejtje me shkrim” datë 22.11.2019. Pas ankimit ndaj kësaj vërejtje, në datë 11.12.2019, Komisioni Disiplinor vendosi propozimin për lirim nga Shërbimi. Pas kundërshtimit administrativ ndaj lirimit nga Shërbimi, Drejtori i SHISH nxori urdhrin e përjashtimit nga shërbimi datë 30.12.2019

Ankuesi pretendon se kërkesat e tij me shkrim për titullimin si inspektor i LIO, kanë përshkallëzuar përdorimin e disa instrumenteve bllokuese, si: ngatërresa e emërimit me ngritjen në detyrë; ulja e nivelit të vlerësimit vjetor të punës; dhënia e masave disiplinore; instrumentalizimi i drejtuesve dhe komisioneve të shqyrtimit.

Sipas ankuesit, ka një ngatërrim të qëllimshëm midis “emërimit” për ngritje në detyrë” dhe “emërimit” pas përfundimit të kursit bazë, si inspektor i LIO. Sipas ligjit Për Statusin, dy kërkesat kryesore që lidhen me ngritjen në detyrë janë vlerësimi i punës në nivelin “shumë mirë” dhe mos pasja e masave disiplinore të pashlyera. Këto dy kushte nuk përfshijnë kursantët që pranohen rishtaz në kursin bazë të SHISH për inspektorë të LIO. Pra nuk ka pse të përfshijë as punonjësit që mbarojnë të njëjtin kurs, njëkohësisht dhe së bashku me ta.

Starti fillestar i nisjes së një karriere profesionale në SHISH përcaktohet nga lloji i karrierës dhe shkalla/formimi bazë për ta nisur këtë karrierë. Nuk ka kuptim të thuhet se kemi ngritje në detyrë nga ndihmës inspektor në inspektor, kur ndihmës inspektori është i kualifikuar vetëm për një specialitet, ndërsa inspektori është formuar për disa. Prandaj, në çdo kapërcim të këtij lloji kërkohet pranimi fillestar në ose për një nivel të ri, me një emërim të ri. Ky emërim dallon nga emërimet pasuese, sepse hap rrugën për një karrierë të re, ku ngritjet në detyrë marrin kuptim. Edhe sipas akteve të brendshme, nënkuptohet që sistemi i karrierës në SHISH nuk nis nga pozicioni i ndihmës inspektorit, por nga pozicioni i inspektorit. Kjo pasi përcaktohet se “plotësimi i afatit minimal të qëndrimit në klasën e nivelit përkatës”, është i barabartë me “dy vjet për klasë të një niveli” (Rr.B.30 dhe 31) Fakti që ky kriter nuk është zbatuar asnjëherë për ndihmës inspektorë, tregon se nuk ka lidhje me ta. Pra zbatimi i kushteve për vlerësimin e punës dhe disiplinën marrin kuptim vetëm pas stazhit dy vjeçar (në fakt tre vjeçar-me gjithë vitin e provës) në nivelin e inspektorit të bazës. Veç emërimeve pa konkurim, që janë në kompetencë të Drejtorit të Shërbimit, në asnjë rast nuk ka patur “konkurime të brendshme” për emërim në nivelin fillestar të inspektorit të LIO në bazë, por vetëm për emërimet në nivelet më sipër, ku parapëlqehet një përvojë dhe stazh i mëparshëm pune, së paku si inspektor i LIO në bazë.

Ankuesi pretendon se, pas kërkesës së parë me shkrim për emërimin si inspektor të bërë në datën 11.06.2018, në dhjetor 2018 është improvizuar vlerësimi “mjaftueshëm”, vlerësim i cili pasi u ankimua prej tij, u ngrit në nivelin “Mirë” (me gjithë pretendimin e ankuesit për “shumë mirë”) Disa ditë më pas, sipas ankuesit u pasua me një incident në datën 09.01.2019 që synonte dhënie mase. Ky incident sipas ankuesit ishte kryer nën drejtimin dhe nxitjen hakmarrëse të shefit të seksionit.

Pas ankesës, gjatë periudhës shkurt-prill 2019, ankuesi informon se nga SHISH pati disa spekulime dhe kontrole në Drejtorisë X, ku është pyetur edhe ai vetë. U shkarkua drejtori i Drejtorisë X ndërsa shefi i seksionit nuk u prek, ndërsa ankuesit i plotësuan kërkesën për të qarkulluar në një seksion tjetër. Edhe në seksionin tjetër, ankuesi pretendon se sërish u vendos nën presion, se mos ngrinte probleme atje.

Deri në këto momente, përveç kërkesës së bërë në qershor 2018 drejtuar Drejtorisë përgjegjëse për burimet njerëzore, kërkesat për titullim inspektor ishin përmendur tërthorazi dhe nuk kishte paraqitur ndonjë ankesë me shkrim direkt ndaj Drejtorit të SHISH. Përmendja tërthorazi te letra për Drejtorin e SHISH dilte në kontekstin e prapavijës për sajimin e problemeve dhe nxitjen e përplasjeve ndaj personit të tij (për të penguar emërimin), se sa si një kërkesë e mirëfilltë për titullimin inspektor.

Në ligjin për Statusin përcaktohet se, punonjësi i SHISH , kur “ka masë disiplinore të pashlyer, nuk mund të ngrihet në detyrë (neni 10, pika 2). Kjo klauzolë sipas ankuesit është përdorur në mënyrë tendencioze në përgjigje të kërkesave me shkrim të ankuesit për t’u emëruar inspektor. Pas kërkesës së datës 23.04.2019, ndaj ankuesit është marrë masa disiplinore “vërejtje me paralajmërim” e datës 25.07.2019.

Pas kundërshtimit administrativ të datës 27.08.2019, ka pasuar ulja në detyrë, pa motivacion në datën 30.09.2019 (që në fakt është e barazvlefshme me një masë tjetër disiplinore, akoma më të rëndë, pasi ulja në detyrë parashikohet si masë disiplinore nga ligji) Gjithashtu, pas kërkesave të datës 14.10.2019 dhe datë 21.11.2019, ka pasuar masa disiplinore “vërejtje me shkrim” në datë 22.11.2019. Në vazhdim, pas datës 22.11.2019, ankuesi shprehet se është kufizuar vetëm në kërkesat për rrëzimin e masës, përfshi kërkesën ankimore të datës 11.12.2019 dhe kundërshtimin administrativ datë 27.12.2019. Tendanca hakmarrëse sipas ankuesit po arrinte kulmin, përkatësisht me vendimin e Komisionit për lënien në fuqi të “vërejtjes me shkrim” dhe propozimin të Drejtorit i SHISH masën për “lirim nga Shërbimi” Në datën 30.12.2019, Drejtori i Shërbimit vendosi “përrjashtimin nga shërbimi”.

Ngatërresat dhe instrumentet e mësipërme sipas ankuesit janë përdorur dhe kanë funksionuar në kushtet kur disa drejtues njerëzorë dhe komisionesh, që kanë proceduar në vlerësimet dhe masat ndaj tij, nuk janë treguar objektivë në shqyrtimin e rasteve konkrete, pavarësisht fakteve të paraqitura, duke filluar nga drejtuesit e Drejtorisë X dhe Drejtorisë Y, për të vijuar më tej me drejtorinë përgjegjëse për burimet njerëzore, Drejtorisë Z, Drejtorin S, Komisionin Disiplinor në SHISH dhe deri tek Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të SHISH. Krahas faktit që shumica e tyre janë zgjedhur dhe emëruar nga dy drejtorët e fundit të SHISH, ndoshta ka koinciduar për keq edhe

fakti tjetër që përplasjet me eprorin direkt, me origjinë nga Korça, janë shqyrtuar dhe inspektuar nga disa drejtues të tjerë, gjithashtu me origjinë nga Korça. Ndërsa kronologjia e ngjeshur e ngjarjeve dhe rënia ndesh me të vërtetën, bën të dyshosh se qëndrimet e tyre të verbale mund të jenë udhëzuar nga më lart. Si provë e tërthortë për këtë mund të sillet fakti i ndryshimit të masës disiplinore të fundit nga “lirim nga shërbimi” të propozuar prej Komisionit Disiplinor, në “përrjashtim nga Shërbimi” të vendosur prej “Drejtorit të SHISH”. Kjo provon vullnetin e Drejtorit të SHISH për largimin nga Shërbimi me çdo mënyrë, pasi sipas ligjit për Statusin dhënia e masave disiplinore nuk përbën shkak për lirimin nga shërbimi. Në mungesë të klauzolave të tjera për largimin nga Shërbimi, sipas ankuesit Drejtori i SHISH ka zgjedhur të aplikojë “përrjashtimin nga Shërbimi”, pavarësisht nga lloji dhe masa e shkeljes së presupozuar. Ky fakt ekspozon pritshmërinë e Drejtorit të SHISH në lidhje me propozimin e masës. Ndërsa një pritshmëri e tillë mund t’u jetë përcjellë më herët drejtuesve të njërive përgjegjëse, që përbëjnë Komisionin Disiplinor.

Sipas ankuesit kjo mund të provohet me guximin për shkeljet ligjore në aktet e dhënies së masave disiplinore, sikurse janë: 1) shkelja e kompetencave administrative; 2) shkelja e parimit të proporcionalitetit; 3) shkelja e dispozitave të procedurës administrative; 4) shkelja e dispozitave të formës dhe elementëve të detyrueshëm të aktit administrativ.

Ankuesi deklaron se, ndërsa elementët e diskriminimit ndaj tij janë shfaqur edhe më herët, duke filluar me mosmërimin inspektor pas përfundimit të kursit bazë si inspektor i Linjës Informativo-Operative në SHISH datë 04.04.2014, ai ka vazhduar periodikisht, deri në datën 30.12.2019 kur ka dalë urdhri i përrjashtimit, ose deri në datë 04.02.2020, kur ka marrë përgjigjen nga Drejtori i SHISH idhur me ankesën që ai kishte bërë ndaj përrjashtimit.

Përrfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri rregullimin dhe marrjen e masave si më poshtë:

1. Konstatimin e faktit të diskriminimit.
2. Rivendosjen e të drejtave të cënuara nga data 04.04.2014 dhe deri aktualisht në formën e dëmshpërblimit pasuror dhe jo pasuror si pasojë e diskriminimit.
3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve me urdhrat nr.520/3 datë 25.07.2019, nr.414/1 datë 22.11.2019, nr.25-627 datë 30.12.2019.4.
4. Rikthimin e ankuesit në SHISH dhe emërimin si inspektor LIO.
5. Rrëzimin dhe fshirjen e motivacionit të përrjashtimit nga SHISH. Veçimi nga aneksi përkatës i dosjes personale të ankuesit pranë Drejtorisë përgjegjëse për burimet njerëzore dhe asgjësimin e materialeve që ruhen aty, për rastet e “paralajmërimit me shkrim” dhe /ose në rastet e masave më të rënda.
6. Rekomandim në bërjen e disa akteve normative të hapura (jo sekrete) si rregullorja e disiplinës, e karrierës, e vlerësimit të punës, e konkurimit, e burimeve njerëzore etj, duke i zhveshur ato nga elementët sekretë. Elementët e domosdoshëm të klasifikuara lidhur me to mund të përrfshihen te rregullorja e brendshme ose te ndonjë aneks i veçantë.
7. Rekomandim për parashikimin e një lloji të ri klasifikimi të dokumenteve zyrtare, për nivelin jo sekret, në mënyrë që ky lloj informacioni të mund të ndahet pa pengesa me institucionet e tjera

publike, kur nevojitet ky informacion. 8. Rekomandim për amendimin e ligjit Për statusin e punonjësit të SHISH, posaçërisht në lidhje me rastet e përjashtimit nga Shërbimi (ose të masave për shkeljet e rënda në përgjithësi) sipas modelit të ligjit për Shërbimin Civil (në mënyrë që punonjësi i SHISH të jetë më i mbrojtur nga vendimet arbitrare brenda SHISH). 9. Parashikimi në aktet normative të brendshme të SHISH dhe/ose në amendimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi të të drejtës së Komisionerit për t'u njohur me informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" për rastet e tjera, kur nevojitet të krahasohet me rastin e palës që ankohet për diskriminim.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD dhe që lidhen me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkaqet e pretenduara prej tij.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1140/2 prot, datë 11.08.2021, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga SHISH, në lidhje me pretendimet e parashtruara nga ankuesi. SHISH ktheu përgjigje me shkresën nr. 1006/1 prot., datë 18.08.2021<sup>4</sup>, duke parashtruar ndër të tjera se:

Një pjesë e dokumenteve të kërkuara apo informacioneve që do të përdreshin për parashtrimet e kërkuara, ishin të klasifikuara “sekret shtetëror”, në nivelin e klasifikimit “Sekret” ose pjesë e këtyre praktikave. Për këtë arsye SHISH kërkoi nga Komisioneri vënien në dispozicion të kopjes së Certifikatës së Sigurisë së Personelit (CSP), për personat që do të marrin dijeni mbi këto të dhëna, si dhe nëse institucioni i Komisionerit disponon një listë të dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”, të miratuar nga autoriteti klasifikues. Këtë kërkesë SHISH e bazon në ligjin nr.8457/1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar dhe VKM nr.188, datë 04.03.2014 “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e personelit”, neni 4.

2. Me shkresën nr.1247/2 prot datë 29.09.2021, Komisioneri përsëriti kërkesën për informacion Drejtuar SHISH, duke kërkuar dërgimin e parashtrimeve dhe akteve të cilat nuk ishin të klasifikuara, si dhe informacion në lidhje me fillimin e procesit për rishikimin e klasifikimit të dokumentacionit, që ka lidhje me pretendimet e ngritura nga ankuesi dhe kohën brenda të cilit ky proces parashikohej të përfundonte.

3. Me shkresën nr. 1006/3 prot., datë 05.10.2021, SHISH ktheu përgjigje duke informuar ndër të tjera se:

SHISH nuk ka refuzuar kërkesën e Komisionerit, por ka shprehur gadishmëri për bashkëpunim. Në zbatim të legjislacionit në fuqi, SHISH shprehet se ka kërkuar informacion nëse Komisioneri është i pajisur me certifikatën e sigurisë duke dhënë të drejtën e njohjes me informacionin e klasifikuar objekt i kërkesës.

SHISH informoi se kishte filluar procedurën për rishikim të dokumentacionit të klasifikuar dhe se në këto kushte në zbatim nenit 17/5, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” afati për vlerësimin e dhënies së informacionit të kërkuar shtyhej me 30 ditë pune.

4. Ankuesi është njohur me përgjigjet e SHISH dhe ka depozituar kundërshtimet e tij në lidhje me vënien në dispozicion të dokumentacionit, të cilat janë administruar si më poshtë:
  - me e-mail datë 10.09.2021 “Kundërshtim administrativ mbi përgjigjen e SHISH shkresa nr.1006/1 datë 18.08.2021”;
  - me e-mail datë 16.09.2021 “Mendime dhe shpjegime;”
  - me shkresën nr.1247/1 prot datë 17.09.2021, janë dërguar me postë dy materialet e mësipërme të dërguara paraprakisht me e-mail si më sipër cituar;
  - me e-mail datë 17.10.2021 “Kundërshtim administrativ mbi përgjigjen e SHISH shkresa nr.1006/3 date 05.10.2021”;
  - me e-mail date 25.10.2021 “Mendime dhe shpjegime mbi dy përgjigjet e SHISH datë 18.08.2021 dhe 05.10.2021.”

---

<sup>4</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1140/3 prot., datë 19.08.2021.

- me shkresën nr. 489 prot datë 26.10.2021 janë dërguar me postë dy materialet e mësipërme të dërguara paraprakisht me *e-mail* si më sipër cituar.

5. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>5</sup>, të ndryshuar dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 03.11.2021. Mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga SHISH, Komisioneri vendosi të shtyjë seancën dëgjimore në mënyrë që SHISH të kishte kohë të vendoste në dispozicion dokumentacionin në lidhje me ankesën.

6. Me shkresën nr.1006/7 prot., datë 10.11.2021, SHISH depozitoi parashtrimet në lidhje me ankesën dhe dokumentacionin shoqërues, duke parashtruar ndër të tjera, se:

Ish-punonjësi E.A ka filluar punë në SHISH me urdhrin e Drejtorit të SHISH nr.18-138, datë 21.05.2012, i klasifikuar “sekret shtetëror”, referuar kërkesës së tij për punësim nr.38 prot datë 16.04.2012, pa konkurim, në zbatim të ligjit nr. 9357, datë 17.03.2005 “*Për statusin e punonjësit të shërbimit informativ të shtetit*”, të ndryshuar.

SHISH përgatit punonjësit e rinj që bëhen pjesë e strukturës së tij me ose pa konkurim, duke i trajnuar ata me anë të kursit bazë për formim profesional për shkak të natyrës së veçantë të punës, në zbatim të nenit 6, të ligjit nr.9357, datë 17.03.2005 “*Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit*”, të ndryshuar.

Në vitin 2013, me urdhrin e Drejtorit të SHISH nr.19-1107, datë 06.09.2013, dokument i klasifikuar “sekret shtetëror”, është miratuar fillimi i kursit bazë në shërbim, ku midis personave të miratuar për të ndjekur këtë kurs ishte dhe E.A. Këtë kurs ai e përfundoi më datë 04.04.2014 (*shih vendimin e KDZH nr.10/1, datë 02.11.2021*). Kryerja e kursit bazë profesional, është detyrim për të gjithë punonjësit e SHISH, pavarësisht nivelit, klasës. Referuar vlerësimeve të punës dhe kohës së detyrueshme të qëndrimit në një nivel apo klasë, punonjësit kanë të drejtën e përparimit në karrierë në varësi edhe të përshtatshmërisë që kanë me vendet e lira të punës. Kështu, ish-punonjësi E.A, e ka fituar statusin e punonjësit të SHISH që në momentin e emërimit me urdhër të Drejtorit të SHISH nr.18-138, datë 21.05.2012. Për sa më sipër, SHISH nuk ka detyrim ligjor për ndryshimin e pozicionit të punës të E.A vetëm pse kreu kursin e formimit bazë.

Që në vitet e para të punës, përkatësisht në vitin 2014, E.A, gjatë ushtrimit të detyrës, ka kryer shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për të cilën ka marrë masë disiplinore me urdhrin nr.226/2, datë 29.05.2014 “*vërejtje me paralajmërim*” e klasifikuar “sekret shtetëror”. (*shih vendimin e KDZH nr.10/1 datë 02.11.2021*) Kjo shkelje konsiston në moskryerjen me dashje të një procesi pune, duke e dëmtuar procesin në tërësi. Kjo masë disiplinore nuk është ankimuar nga E.A.

Në vitin 2016, ndaj tij është dhënë një tjetër masë disiplinore “*vërejtje me shkrim*”, me urdhrin nr .461/1, datë 29.08.2016, të njësisë ku punonte E.A, me motivacionin “*Për mosrealizim të detyrës*”

<sup>5</sup> Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar: “*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.*”

gjatë procesit të punës”, e klasifikuar “sekret shtetëror” duke dëmtuar sërish procesin e punës së shërbimit (*shih vendimin e KDZH nr.10/1, datë 02.11.2021*). Këtë masë disiplinore, E.A, e ka ankimuar në Komisionin Disiplinor, i cili me vendimin nr.17/1, datë 16.09.2016, pasi ka dëgjuar palët, në zbatim të nenit 47 e në vijim të ligjit nr. 9357, datë 17.03.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar dhe Rregullores nr.13-53, datë 08.04.2008 “Për disiplinën në Shërbimin Informativ të Shtetit”, ka vendosur lënien në fuqi të masës disiplinore (*shih vendimin e KDZH nr.10/1 datë 02.11.2021*). Komisioni i Disiplinës, me shkresën nr. 16/7 prot., datë 23.09.2016 ka njoftuar dakortësinë e Drejtorit të SHISH për lënien në fuqi të masës (*shih vendimin e KDZH nr.10/1, datë 02.11.2021*)

E.A, në datë 11.06.2018, i është drejtuar Drejtorit të SHISH, me kërkesën nr.1099 prot, datë 10.07.2018, për emërimin e tij si inspektor në një njësi të SHISH, duke e trajtuar rastin e tij si emërim nga e para me pretendimin se kishte përfunduar kursin. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga SHISH, pasi sipas nenit 10 “Ngritja në detyrë”, të ligjit nr.9357 datë 17.03.2015 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të ndryshuar, ku citohet: “1.Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit mund të ngrihet në detyrë kur vlerësohet me shkallën “shumë mirë”. 2. Punonjësi, që ka masë disiplinore të pashlyer, nuk mund të ngrihet në detyrë”

E.A, nuk plotësonte kriterin e vlerësimit të punës pasi e kishte “mirë” si dhe kishte marrë dy masa disiplinore gjatë gjithë periudhës së punës si ndihmës inspektor, pasqyruar këto në relacionin e burimeve njerëzore për Drejtorin e SHISH, të datës 10.07.2018, lëndë “ Mbi kërkesën për ngritje në detyrë të z. E.A”. Pretendimi i ankuesit, për ta trajtuar rastin e tij si emërim nga e para dhe jo ngritje në detyrë sepse kishte përfunduar kursin bazë, nuk ka mbështetje ligjore, sepse E.A ishte punonjës i shërbimit, që do të thotë se ishte pranuar dhe emëruar një herë punonjës i SHISH, duke kaluar të gjitha procedurat e emërimit. Kërkesa e E.A është trajtuar si ngritje në detyrë, pasi kërkohej kalimi nga ndihmës inspektor në inspektor, pra kishte ndryshim në nivel. Kjo kërkesë nuk u mor në konsideratë për shkak të mosplotësimit të kriterit të nenit 10, të ligjit nr. 9357/2005 dhe jo për ndonjë arsye diskriminimi, siç pretendon E.A.

Në vitin 2019, me urdhrin nr. 520/3 prot., datë 25.07.2019, të njësisë ku punonte E.A, i është dhënë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, me motivacionin: “Shkelje të rregullave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për ruajtjen e sekretit shtetëror në SHISH, kur nuk përbën vepër penale”. Arsyeja e dhënies së kësaj mase ka të bëjë me faktin se E.A ka frekuentuar ambientet e SHISH, të cilat nuk mund të frekuentohen nga struktura të veçanta të SHISH, në zbatim të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, të ndryshuar. Gjithashtu ky regjim gjen rregullim edhe në aktet e brendshme nënligjore, për të cilat E.A ka qenë në dijeni. Dokumentet që lidhen me rastin në fjalë dhe administrohen në këtë njësi, janë përjashtuar nga deklasifikimi me vendimin nr. 9/1, datë 02.11.2021 të KDZH, i klasifikuar “sekret shtetëror”. E.A e ka ankimuar këtë urdhër në Komisionin e Disiplinës, i cili me vendimin nr. 37/4 prot., datë 15.08.2019, i klasifikuar “sekret shtetëror” e ka lënë në fuqi masën disiplinore (*shih vendimin e KDZH nr.10/1 datë 02.11.2021*). Në shkresën nr. 37/7 prot., datë 28.08.2019 të Komisionit të Disiplinës, citohet se, me shkresën nr. 37/5 prot., datë 15.08.2019, është informuar Drejtori i SHISH mbi vendimarrjen e Komisionit të Disiplinës për lënien në fuqi të masës disiplinore dhe më

datë 28.08.2019, drejtori i SHISH ka lënë në fuqi propozimin e Komisionit të Disiplinës (*shih vendimin e KDZH nr.10/1 datë 02.11.2021*).

E.A, përveç ankimit të masës në Komisionin e Disiplinës, i është drejtuar edhe Drejtorit të SHISH, me kërkesën nr. 75/1, datë 02.09.2019, për mënyrën dhe arsyen e dhënies së masës disiplinore. Drejtori i SHISH, e ka adresuar këtë ankesë të E.A tek një njësi tjetër në SHISH, e cila në zbatim të rregullores së saj, ka bërë kontroll duke vlerësuar procedurën dhe shkakun ligjor të dhënies së masës, pranë njësisë ku punonte ai. Në përfundim, me raportin e vlerësimit “*Mbi kundërshtimin administrativ të përcjellë nga punonjësi E.A me detyrë ndihmës inspektor*” me shkresën nr.75/6 prot., datë 25.09.2019 (*shih vendimin e KDZH nr.12/1, datë 02.11.2021*), është konstatuar se veprimet e ndjekura nga njësia e cila ka dhënë masën disiplinore nr.520/3, datë 25.07.2019, janë kryer konform akteve në fuqi dhe i kanë rekomanduar Drejtorit të SHISH, transferimin e E.A në një detyrë tjetër, jashtë njësisë të veprimtarisë informative.

Duke qenë se, që prej fillimit të punës në SHISH, E.A ka kryer disa shkelje si dhe mbështetur në rekomandimet e dhëna nga njësia që ka kryer kontrollin, Drejtori i SHISH me urdhrin nr. 25-536, datë 30.09.2019 (*shih vendimin e KDZH 10/1 date 02.11.2021*), i klasifikuar “sekret shtetëror”, e ka liruar E.A nga detyra që ai mbante dhe e ka emëruar në një njësi tjetër në shërbim, brenda të njëjtit nivel. Me marrjen e detyrës së re, si ndihmës inspektor-roje, E.A, i është nënshtruar një trajnimi 3 javor mbi njohjen e akteve nënligjore dhe zbatimin e rregullave të sigurimit teknik të armës etj. Me përfundimin e trajnimit, E.A në kundërshtim me aktet e brendshme, ka kryer shkelje që konsistojnë në mospatullimin dhe mosraportimin gjatë shërbimit të rojës, mos ardhjen me uniformën e punës, mos qëndrimin korrekt në vend roje, si dhe pa arsye nuk është paraqitur të marrë shërbimin e rojes sipas planit, shkelje këto të pasqyruara në shkresën nr.414 pro.,t datë 22.11.2019 (*shih vendimin e KDZH nr.11/1 datë 02.11.2021*), lëndë “*Informacion mbi dhënie mase disiplinore për n/inspektorin (roje) E.A*”, i klasifikuar “sekret shtetëror”.

Sa më sipër, për shkak të shkeljeve të vazhdueshme të akteve nënligjore, drejtuesi i njësisë, me urdhrin nr. 414/1 prot., datë 22.11.2019 (*shih vendimin e KDZH nr.10/1 datë 02.11.2021*), ka dhënë masën disiplinore “vërejtje me shkrim”, e klasifikuar “sekret shtetëror”, për E.A, me motivacionin: “*Për shkelje të disiplinë formale në punë lidhur me mosrespektimin e Manualit të Shërbimit*”. E.A e ka ankimuar këtë vendim në Komisionin Disiplinor, me kërkesën nr. 42, datë 11.12.2019. Komisioni Disiplinor, ka dëgjuar palët dhe me vendimin nr. 42/4, datë 19.12.2019 (*shih vendimin e KDZH nr.7/2 datë 01.11.2021*), ka vendosur ti propozojë Drejtorit të SHISH dhënien e masës disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*”, pasi masa disiplinore e propozuar nga njësia ishte e argumentuar dhe konform akteve të brendshme, por punonjësi ka kryer disa shkelje disiplinore të dokumentuara sa më sipër, madje ende pa shlyer masën e mëparshme. Në zbatim të këtij vendimi, Drejtori i SHISH, ka miratuar urdhrin nr. 25-627, datë 30.12.2019, për “*Përrjashtim nga Shërbimi*”, me motivacionin “*Për shkelje të detyrave të përcaktuara në ligjin nr.9357, datë 17.03.2005 “Për statusin e punonjësit të SHISH”*”. Dhënia e masës disiplinore përrjashtimi nga shërbimi, ka ardhur në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për faktin se:



Masat e mëparshme të dhëna ndaj këtij punonjësi jo vetëm nuk e kanë ndërgjegjësuar E.A për t'u vetëkorrigjuar dhe për të përfituar nga mundësitë që shërbimi i ka dhënë, por ka nxjerrë në pah karakterin e tij të vështirë, për të punuar brenda kufizimeve ligjore që ka puna në SHISH.

Në nenin 49, të ligjit nr.9357, datë 17.03.2005 "*Për statusin e punonjësit të SHISH*", të ndryshuar, përcaktohet se Komisioni Disiplinor del me propozime përpara Drejtorit të SHISH, i cili vendos për marrjen, ndryshimin dhe mos zbatimin e masës. Përrjashtimi nga shërbimi është një masë e justifikuar, duke marrë parasysh se ndaj E.A nuk është hera e parë që është aplikuar me masë disiplinore.

Në pikën 2, të nenit 11 të rregullores nr. 24-95, datë 03.06.2019 "*Për disiplinën në SHISH*", përcaktohet se masat e mëparshme jepen në mënyrë të përshkallëzuar në përputhje me llojin e shkeljes dhe të pasojave të saj, por në pikën 4, të nenit 14, të kësaj rregullore përcaktohet se punonjësi i SHISH përjashtohet nga shërbimi për shkelje të rënda disiplinore, pa qenë i nevojshëm zbatimi sipas radhës i masave disiplinore të nenit 11 të kësaj rregulloreje.

Duke qënë se, në ankimin e paraqitur pranë Komisionerit, E.A krahas të tjerave pretendon edhe për paligjshmërinë e aktit administrativ, SHISH sqaron se, të drejtën për shpalljen e paligjshëm të një akti administrativ, e ka vetëm gjykata me vendim të të formës së prerë. Deri më tani, SHISH nuk ka njoftim nga gjykata që E.A ta ketë goditur gjyqësisht këtë akt administrativ, ku do të kishte mundësi të kërkonte jo vetëm pavlefshmërinë e aktit por edhe demshpërblim nëse ky akt do të ishte i paligjshëm, por siç duket edhe ai vetë është i ndërgjegjshëm që masat disiplinore të marra ndaj tij, janë në përputhje të plotë me ligjin material, procedural dhe proporcionale me shkeljet nga vetë E.A.

SHISH sqaron se, E.A ka patur dy vlerësime pune për vitin 2019 për shkak të punës së tij në dy njësi të ndryshme, ku për periudhat 01 dhjetor 2018-30 shtator 2019 është vlerësuar nga eprori për punën e tij në nivelin "jo mjaftueshëm" ndërsa për periudhën 01 tetor-30 nëntor 2019 është vlerësuar "mirë". Duke mos qenë dakort me këto vlerësime, E.A i është drejtuar Drejtorit të SHISH me kërkesën ankimore nr. 1187, datë 14.10.2019, mbi mënyrën e vlerësimit. Në vlerësim të kësaj ankese, Drejtori i SHISH ka investuar njësinë e kontrollit të SHISH e cila me raportin e vlerësimit nr.101/2 prot., datë 31.12.2019 (shih vendimin KDZH 12/1 datë 02.11.2021) ka vlerësuar se janë zbatuar procedurat për vlerësimin e punonjësit dhe vlerësimi i punës për periudhën janar-shtator 2019, të qëndrojnë në nivelin "jo mjaftueshëm". Për përgjigjet e kërkesave dhe ankesave të tij, E.A është njoftuar nga eprorët e tij, duke qenë se ishte punonjës në strukturat e SHISH.

Sa më sipër, ndaj E.A, SHISH në asnjë rast, nuk ka ndjekur ndonjë procedurë diskriminuese, për asnjë shkak të pretenduar prej tij në ankesën drejtuar Komisionerit, që lidhet me gjendjen arsimore, shoqërore, përkatësinë prindërore, përkatësinë në grup të veçantë apo çdo shkak tjetër. SHISH ka zbatuar me rigorozitet të gjitha procedurat lidhur me dhënien e masave disiplinore ndaj E.A. Për këtë institucioni ka shfrytëzuar të gjitha hapësirat ligjore dhe administrative për vlerësimin dhe rivlerësim të të gjitha ankesave dhe kërkesave të tij, madje duke i dhënë mundësi disa herë për t'u përmirësuar në punë, fakt të cilin ai nuk e ka shfrytëzuar.

Ju bëjmë me dije se, aktualisht pjesë e stafit të SHISH, si i punësuar prej vitesh, është edhe babai i E.A.

Për sa i përket urdhrin nr. 21-145, datë 29.09.2016 “Për listën e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror” në SHISH”, të kërkuar nga Komisioneri, SHISH informon se, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit në SHISH, mori në shqyrtim këtë dokument dhe me vendimin nr.13/1, datë 02.11.2021, i klasifikuar “sekret shtetëror” vendosi përjashtimin nga deklasifikimi të këtij dokumenti.

7. Parashtrimet e SHISH, i’u komunikuan ankuesit, i cili depozitoi kundërshtimet e tij me *e-mail* në datë 20.12.2021 dhe nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1489/3 prot., datë 21.12.2021.
8. Me shkresën nr. 50 prot., datë 10.01.2022, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 27.01.2022, seancë e cila nuk u zhvillua për arye shëndetësore të personave përgjegjëse të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në vijim, me shkresën nr .209 prot., datë 7.2.2022, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 18.2.2022, e cila nuk u zhvillua për shkak të pamundësisë së përfaqësuesve të SHISH për të marrë pjesë.

Për të mundësuar pjesëmarrjen e SHISH në seancë dëgjimore, Komisioneri me shkresën nr. 460 prot., datë 16.03.2022, njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 24.03.2022. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 24.03.2022, me pjesëmarrjen e të dy palëve, ankuesit i cili u paraqit personalisht prezent dhe SHISH, i cili u përfaqësua nga E.P, dhe L.H, të pajisur me autorizimin nr. 102 prot., datë 24.1.2022.

Me shkresën nr. 25/1 prot., datë 24.01.2022 dhe në referim të nenit 10, të ligjit nr. 8391, datë 28.10.1998 “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8391/1998), SHISH kërkoi zhvillimin e seancës dëgjimore me dyer të mbyllura.

Gjatë seancës dëgjimore, palët mbajtën të njëjtin qëndrim që kishin përcjellë pranë Komisionerit nëpërmjet komunikimit shkresor.

Ndër të tjera gjatë seancës dëgjimore, ankuesi ngriti pretendimin se në të vërtetë përjashtimi i tij nga shërbimi ka ndodhur pasi ai ka denoncuar vjedhjen e karburantit që bëhej në strukturat e SHISH.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e SHISH, theksoi faktin se strukturat e SHISH janë sekrete, pasi struktura e SHISH që përfshin të gjitha strukturat operative të tij, është dokument i klasifikuar dhe miratohet nga Kryeministri. Përfaqësuesja e SHISH, parashtrroi si argumenta shtesë në lidhje me kursin bazë, të cilat nuk ishin pjesë e parashtrimeve me shkrim të depozituara paraprakisht nga ana e këtij institucioni,. Sipas saj, interpretimi i ligjit nuk bëhet vetëm fjalë për fjalë, por ligji

interpretohet në tërësinë e tij. Në ligj autorizohet kursi bazë, për formimin bazë të punonjësvë të SHISH. Për shkak të natyrës së veçantë që ka, SHISH ka të ngritur një strukturë që bën trajnimin bazë, për marrjen e bazave për ushtrimin e këtij profesioni, sepse formimi juridik ose ekonomik nuk të bën të aftë për të ushtruar detyrën e një inspektori kërkimi në SHISH. Por, mjafton të jesh pjesë e këtij trajnimi të formimit bazë dhe marrjen e kualifikimeve të herëpashershme më vonë, të cilat të aftësojnë për të ushtruar këtë profesion. Në ligj bëhet fjalë për kursin bazë dhe pretendimet e palës ankuese janë të pabazuara. Gjithashtu, ka edhe një VKM nr.1400, të vitit 2008, e cila flet për organizimin e kurseve në SHISH dhe trajnimin e pjesëmarrësve, dhe konkretisht në pikën 1, parashikon se, në Institutin e Shërbimit Informativ të Shtetit organizohen kurse për përgatitjen informative e formimin bazë profesional dhe së dyti, për kursantët e rinj inspektor dhe ndihmës inspektor. Pra, detyrimi për të kryer kursin bazë është si për inspektorët ashtu edhe për ndihmës inspektorët. Fakti i bërjes së këtij kursi nuk do të thotë detyrim automatik për SHISH që të emërojë inspektorë ose ndihmës inspektor. Ankuesi ka qenë i punësuar në institucion më herët dhe ka përmbushur detyrimin ligjor për kryerjen e kursit bazë.

Në lidhje me pyetjen e parashtruar nga ana e Komisionerit gjatë seancës dëgjimore, nëse ka punonjës të tjerë në SHISH, që kanë kryer kursin bazë dhe nuk janë emëruar inspektorë, përfaqësuesja e SHISH, deklaroi se: *“Pozicioni i sekretarit, aktualisht në SHISH është në pozicion inspektor ndihmës dhe pothuajse në 90 % të stafit që ushtrojnë aktualisht detyrën në këtë pozicion janë të gjithë të arsimuar me arsim të lartë dhe jo detyrimisht janë inspektor por janë ndihmës inspektor”*.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.**

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultuan të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Ankuesi E.A ka filluar punë në SHISH në bazë të urdhrin nr.18-138, datë 21.5.2012, të Drejtorit të SHISH, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 1, të vendimit nr.10/1, datë 02.11.2021, të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit (KDZH), të ngritur pranë SHISH, në pozicionin e punës “shofer” në një nga njësitë e SHISH.

Me urdhrin nr.19-1107, datë 06.09.2013, të Drejtorit të SHISH, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 10, të vendimit nr.10/1, datë 02.11.2021, të KDZH është miratuar zhvillimi i kursit të përgatitjes dhe formimit bazë profesional për inspektor të linjës operative, nëpërmjet të cilit akuesi është miratuar së bashku me persona të tjerë, për të ndjekur kursin bazë. Ankuesi e përfundoi kursin bazë

në datën 04.04.2014. Që nga momenti i përfundimit të kursit bazë në vitin 2014, ankuesi pretendon se duhet të ishte emëruar inspektor nga ana e SHISH.

Gjatë ushtrimit të detyrës, me urdhrin nr. 226/2 prot., datë 29.05.2014, të drejtuesit të drejtorisë, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 2, të vendimit nr.10/1, datë 02.11.2021, të KDZH, të ngritur pranë SHISH ndaj ankuesit është marrë masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim*”. Kjo masë disiplinore nuk rezulton të jetë kundërshtuar nga ankuesi.

Me urdhrin nr. 461/1 prot., datë 29.08.2016, të drejtorit të drejtorisë, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 3, të vendimit nr.10/1, datë 02.11.2021, të KDZH, ndaj ankuesit është marrë masa disiplinore “*vërejtje me shkrim*”. Ankuesi e ka kundërshtuar masën disiplinore pranë Komisionit të Disiplinës, i cili pas shqyrtimit, në datën 16.9.2016, ka vendosur t’i propozojë Drejtorit të SHISH lënien në fuqi të kësaj mase disiplinore, pasi ishte në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, fakt ky që rezulton nga vendimi nr. 17/1, datë 16.09.2016, i Komisionit të Disiplinës, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 4, të vendimit nr. 10/1, datë 02.11.2021, të KDZH. Bazuar në shkresën nr. 16/7, datë 23.06.2016, të Komisionit të Disiplinës, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 5, të vendimit nr. 10/1, datë 02.11.2021, të KDZH, rezulton se, në datën 22.9.2016, Drejtori i SHISH ka miratuar propozimin e Komisionit të Disiplinës.

Në datën 11.06.2018, ankuesi i është drejtuar Drejtorit të SHISH me kërkesën nr.1099 prot., datë 10.07.2018, nëpërmjet të cilës ka kërkuar emërimin e tij si inspektor në një njësi të SHISH, duke e bazuar këtë kërkim në faktin se ai kishte përfunduar kursin bazë. Nga ana e SHISH, kjo kërkesë e ankuesit është trajtuar si kërkesë për ngritje në detyrë dhe nuk është pranuar nga SHISH me arsyetimin se ankuesi nuk plotësonte kriteret e parashikuara në nenin 10, të ligjit nr. 9357/2005, pasi vlerësimin e punës për vitin 2007 e ka “mirë,” pasqyruar ky fakt në relacionin e burimeve njerëzore të datës 10.7.2018 me lëndë “*Mbi kërkesën për ngritje në detyrë të z. E.A*”.

Me kërkesën nr. 562 prot., datë 23.4.3019, ankuesi i është ridrejtuar Drejtorit të SHISH me një tjetër kërkesë për emërimin e tij si inspektor, me të njëjtat argumenta si më sipër. Bazuar në relacionin e datës 13.05.2019 me lënë “*Mbi mendimin e Drejtorisë..... së kërkesës së z. E.A*”, nuk është dhënë miratimi, pasi ankuesi nuk përmbushte kriteret.

Me urdhrin nr. 520/3, datë 25.7.2019, të drejtuesit të njësisë ku punonte, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje me paralajmërim*” me motivacionin “*Për shkelje të rregullave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për ruajtjen e sekretit shtetëror në SHISH, kur nuk përbën vepër penale*”. Arsyeja e dhënies së kësaj mase disiplinore ndaj ankuesit konsiston në faktin se ankuesi ka frekuentuar ambiente të SHISH (Shtëpinë e Pushimit të SHISH në Himarë), të cilat nuk mund të frekuentohen nga struktura të veçanta të SHISH, në zbatim të ligjit nr. 8391 datë 28.10.1998 “*Për Shërbimin Informativ Kombëtar*”, të ndryshuar (në vijim ligji nr.8391/1998).

Ankuesi e ka ankimuar masën disiplinore në Komisionin e Disiplinës, i cili pas shqyrtimit të ankimit, me vendimin nr. 37/4 prot., datë 15.8.2019, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 6, të

vendimit nr. 10/1, datë 02.11.2021, të KDZH, ka vendosur t'i propozojë Drejtorit të SHISH lënien në fuqi të masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” të dhënë ndaj ankuesit, pasi është marrë konform akteve në fuqi. Referuar shkresës nr. 37/7 prot., datë 28.08.2019 të Komisionit të Disiplinës, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 7, të vendimit nr. 10/1, datë 02.11.2021, të KDZH, rezulton se, Drejtori i SHISH ka miratuar propozimin e Komisionit të Disiplinës.

Përveç ankimit të masës disiplinore në Komisionin e Disiplinës, ankuesi i është drejtuar Drejtorit të SHISH, me një ankesë me lëndë “*kundërshtim administrativ*” ndaj propozimit të Komisionit Disiplinor. Drejtori i SHISH e ka përcjellë ankesën tek një njësi tjetër në SHISH, e cila ka kryer kontrollat përkatëse dhe ka vlerësuar procedurën dhe shkakun ligjor të dhënies së masës nga njësia ku punonte ankuesi. Në përfundim të procesit të vlerësimit, kjo njësi ka hartuar raport vlerësimit mbi kundërshtimin administrativ të bërë nga ankuesi, me nr. 75/6 prot., datë 25.09.2019, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 1, të vendimit nr.12/1, datë 02.11.2021, të KDZH, duke mos konstatuar shkelje në dhënien e masës disiplinore ndaj ankuesit dhe ka rekomanduar transferimin e ankuesit nga pozicioni që mbante dhe emërimin e tij në një detyrë tjetër jashtë njësive të veprimtarisë informative.

Me urdhrin nr. 25-536, datë 30.9.2019, të Drejtorit të SHISH, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 9, të vendimit nr. 10/1, datë 02.11.2021, të KDZH, ankuesi është liruar nga detyra që mbante dhe është emëruar në një njësi tjetër ndihmës inspektor, roje. Në vijim të transferimit rezulton se ankuesit i është bërë vlerësimi i punës, në njësinë e mëparshme, me vlerësimin “jo mjaftueshëm”.

Ankuesi ka paraqitur kërkesën ankimore nr. 1187 prot., datë 14.10.2019, drejtuar Drejtorit të SHISH, duke kërkuar rishikimin e urdhrin të emërimit dhe ndryshimin e vlerësimit të punës. Kjo ankesë është përcjellë për trajtim dhe në këtë kuadër është përgatitur nga njësia përkatëse, relacioni datë 15.10.2019 me lëndë “*Mbi një kërkesë-ankimore nga punonjësi E.A*”. Në këtë relacion theksohet se, lëvizja e ankuesit nuk ka lidhje me vërejtjen, por me problematikat dhe çështjet konfliktuale dhe se pas shqyrtimit të vendeve të lira, i vetmi pozicion i mundshëm për ta sistemuar është sugjeruar pozicioni n/inspektor, roje. Në lidhje me vlerësimin e punës 9 mujor, theksohet se është realizuar në kuadër të transferimit, bazuar në nenin 9, të ligjit nr. 9357/2005. Në lidhje me pretendimet e ankuesit se vlerësimi i punës është tendencioz dhe hakmarrës, theksohet se, ankuesi duhet të ndjekë hapat e ankimit për vlerësimin e punës të përcaktuara në udhëzimin nr.13-200, datë 16.12.2008, për vlerësimin e punës në SHISH. Ndërsa në lidhje me kërkesën e parashtruar nga ankuesi për t'u emëruar inspektor në një njësi të caktuar në SHISH, theksohet se ankuesi nuk plotëson kriteret për ngritje në detyrë, pasi nuk ka vlerësimin e punës “shumë mirë” dhe ka masë disiplinore të pashlyer.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit për vlerësimin e punës dhe vlerësimin e procedurave të ndjekura, është hartuar raport vlerësimi mbi “*Kërkesën ankimore të punonjësit E.A, lidhur me vlerësimin 9 mujor të punës*”, me nr. 84/3 prot., datë 12.11.2019, nga njësia e ngarkuar me këtë detyrë dhe nuk janë konstatuar shkelje në lidhje me procesin e vlerësimit të punës së ankuesit.

Pas marrjes së detyrës së re, si ndihmës inspektor, roje, me urdhrin nr. 414/1, datë 22.11.2019, të drejtuesit të njësisë ku punonte ankuesi, është marrë masa disiplinore “*vërejtje me shkrim*”, me motivacionin “*Për shkelje të disiplinës formale lidhur me mosrespektimin e Manualit të shërbimit.*” Në shkresën nr. 414 prot., datë 22.11.2019 me lëndë: “*Informacion mbi dhënien e masës disiplinore për n/inspektor (roje) E.A*”, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 1, të vendimit nr. 11/1, datë 02.11.2021, të KDZH, evidentohen shkeljet mbi bazën e të cilave është dhënë masa disiplinore ndaj ankuesit.

Ankuesi e ka ankimuar masën disiplinore “*vërejtje me shkrim*” në Komisionin e Disiplinës, me kërkesën ankimore nr. 42 prot., datë 11.12.2019. Komisioni i Disiplinës pasi ka shqyrtuar çështjen me vendimin nr. 42/4, datë 19.12.2019, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 1, të vendimit nr. 7/2, datë 01.11.2021, të KDZH, ka vendosur t’i propozojë Drejtorit të SHISH dhënien e masës disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*”, pasi masa është dhënë konform akteve në fuqi dhe është e përsëritur pa shlyer masën e mëparshme. Bazuar në shkresën nr. 42/7 prot., datë 24.12.2019, të Komisionit të Disiplinës me lëndë “*Mbi vendimin e Drejtorit të SHISH, për masën disiplinore të punonjësit E.A*”, deklasifikuar pjesërisht, sipas pikës 3, të vendimit nr. 7/2, datë 01.11.2021, të KDZH, rezulton se, në datën 23.12.2019, Drejtori i SHISH ka miratuar propozimin e Komisionit Disiplinor.

Me urdhrin nr. 25-627, datë 30.12.2019, të Drejtorit të SHISH, ndaj ankuesit është dhënë masa disiplinore “*Përrjashtim nga shërbimi*” me motivacionin “*Për shkelje të detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të SHISH”.*”

Në datën 27.12.2019 ankuesi ka paraqitur para Drejtorit të SHISH kundërshtimin administrativ kundër propozimit të Komisionit të Disiplinës. Në lidhje me këtë ankim, ankuesit i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1865 prot., datë 31.12.2019, të Drejtorit të SHISH, duke theksuar se kundërshtimi administrativ ndaj propozimit të masës disiplinore nga Komisioni i Disiplinës nuk gjen mbështetje ligjore, pasi ankuesi kishte shteruar të gjitha hallkat administrative të ankimit, të parashikuara në ligjin për statusin e punonjësit të shërbimit dhe për rrjedhojë kërkesa nuk merrej në konsideratë, si e pabazuar në ligj.

Kundër masës disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*”, ankuesi ka paraqitur ankesë pranë Drejtorit të SHISH në datën 22.01.2020, me të cilën kërkon konstatimin e pavlefshmërisë së masës dhe rikthimin e tij në SHISH. Ankuesit i është kthyer përgjigje në lidhje me këtë ankesë me shkresën nr. 18/1 prot., datë 04.02.2020 të Drejtorit të SHISH. Në këtë shkresë theksohet se, përrjashtimi i ankuesit nga SHISH ka ardhur si rezultat i masës disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*” dhe ka si bazë ligjore nenin 47/dh “*Ilojet e masave disiplinore*” dhe jo në referencë të nenit 54, të ligjit nr. 9357/2005, si rezultat i një vendimi të formës së prerë nga gjykata me heqje lirie për krimet e kryera me dashje.

Ankuesi nuk ka kundërshtur gjyqësisht përrjashtimin nga SHISH dhe asnjë nga masat disiplinore të mëparshme të marra ndaj tij.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi, duke pretenduar se mosemërimi i tij nga ndihmës inspektor në inspektor, pas përfundimit të kursit bazë, si dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, deri në përjashtimin nga SHISH, kanë ndodhur për shkak të “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore”, “përkatësisë prindërore” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”. Në lidhje me identifikimin e grupit të veçantë, ankuesi shprehet se, rasti i tij përfshihet në “grupin e punonjësve të SHISH, që janë pranuar fillimisht si ndihmës inspektor, ndërsa kursin bazë e kanë kryer pas emërimit si ndihmës inspektor” si dhe në “grupin e punonjësve të SHISH, që megjithëse janë pranuar fillimisht si ndihmës inspektor, nuk janë përfshirë në kursin bazë të shkurtuar, të parashikuar enkas për këtë kategori punonjësish, por janë pranuar në kursin bazë të plotë, çelur posaçërisht për kursantët e pranuar rishtaz në SHISH, të cilët emërohen inspektorë menjëherë pas përfundimit të këtij kursi”. Ankuesi nuk ka identifikuar ndonjë shkak konkret në kuadër të pretendimit për diskriminim të bazuar në termin “çdo shkak tjetër”.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga LMD, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i këtij ligji si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të LMD.

Ankuesi pretendon se diskriminimi ndaj tij ka ndodhur për më shumë se një shkak. Në referim LMD, pretendimi për diskriminim për më shumë se një shkak, mbulohet nga parashikimet e pikave 3 dhe 5, të ligjit, ku përcaktohet: “3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit. ....5. “Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas.”

Në Kreun II, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD, në nenin 12/1/c, përcakton se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: .....c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet

*profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”.*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose disa nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për punësim në lidhje me pretendimet e parashtruara.

**- Në lidhje me pretendimin e ankuesit për emërimin e tij si inspektor.**

Bazuar në ligjin nr. 9357, datë 17.03.2005 “ *Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit*”, të ndryshuar (në vijim ligji nr.9357/2005), pranimi në SHISH bëhet me konkurim të hapur dhe në raste të veçanta mund të kryhet me urdhër të Drejtorit të SHISH edhe pa konkurim. Ky rregullim parashikohet në nenin 5, pikat 4 e 5, të ligjit të sipërcituar, ku parashikohet : “4. Pranimi në SHISH bëhet me konkurim të hapur, por në raste të veçanta edhe pa konkurim. Shpallja e vendit të lirë të punës botohet në dy gazeta kombëtare me tirazh të madh të pakën 30 ditë para datës së konkursit. Pranimi kalon në fazat e shqyrimin dhe të verifikimit paraprak të dokumentacionit, të testimin me shkrim dhe të intervistës me gojë. 5. Në raste të veçanta dhe për profesione specifike pranimi në Shërbim mund të kryhet me urdhër të Drejtorit pa konkurim.”

Në nenin 6, të ligjit nr. 9357/2005, parashikohet se : *“1. Shtetasi, i cili pranohet në SHISH për t’u trajnuar në kurs, ndërpret marrëdhëniet me këtë Shërbim, nëse gjatë kursit vlerësohet se nuk ka aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave në këtë Shërbim. 2. Marrëdhëniet ndërpriten me urdhër të Drejtorit të SHISH-it, pas propozimit të drejtorit të institutit, të konfirmuar edhe nga njësia e ngarkuar me funksionet e inspektimit.”*

Në nenin 2, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr.9357/2005, parashikohet se: *“Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim: 1. “Kursant” është shtetasi, që përgatitet në kurset e institutit të këtij Shërbimi, për t’u bërë punonjës aktiv i Shërbimit Informativ të Shtetit. 2. “Punonjës në detyrë” është shtetasi në marrëdhënie pune në Shërbimin Informativ të Shtetit.”*



Në nenin 13, pika 1, germa “e”, të ligjit nr. 9357/2005, parashikohet : “1. *Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit ka këto detyra kryesore:..... e) të rrisë aftësitë profesionale dhe të marrë pjesë në veprimtari trajnuese.*”, ndërsa në nenin 30, germa “c”, të po këtij ligji, parashikohet : “*Punonjësi i SHISH-it ka edhe këto të drejta:..... c) të trajnohet, të kualifikohet dhe të ndjekë studimet, brenda e jashtë vendit, me leje të Drejtorit.*”

Sa më sipër rezulton se, shtetasit të cilët pranohen në SHISH nëpërmjet konkursit të hapur, i nënshtrohen një trajnimi për të fituar njohuritë bazë dhe për t’u përgatitur për të ushtruar funksionet dhe detyrat si punonjës i SHISH. Kjo kategori, për efekt të ligjit kategorizohet si “kursantë” dhe në kuptim të përkufizimit që jepet nga neni 2, pika 1 e ligjit nr. 9357/2005 për kursantët, këta të fundit nuk janë emëruar ende punonjës aktivë të SHISH. Kjo kategori nuk është në marrëdhënie pune me SHISH. Kategoria e kursantëve, punësohet në SHISH, pra vendoset një marrëdhënie punësimi midis tyre dhe SHISH dhe ata emërohen në një vend të caktuar pune, vetëm nëse gjatë kursit vlerësohen se kanë aftësitë e nevojshme për kryerjen e detyrave në Shërbim, në të kundërt marrëdhënia e kursantëve të cilët janë pranuar në SHISH ndërpritet me urdhër të Drejtorit të SHISH, sipas rregullave të parashikuara nga neni 6, i ligjit 9357/2005. Në rast se kursantët e pranuar nëpërmjet konkurimit të hapur e kalojnë fazën e trajnimit, ata emërohen në detyrë dhe midis tyre dhe SHISH lidhet marrëdhënia e punësimit.

Sa më sipër, përbën rregullin e përgjithshëm të pranimit në SHISH dhe lindjes së marrëdhënies së punës midis një personi dhe SHISH. Ndërkohë, rezulton se, pranimi në SHISH ndodh edhe pa konkurim, nëpërmjet emërimit në detyrë me urdhër të Drejtorit të SHISH. Nëpërmjet emërimit në detyrë me urdhër të Drejtorit të SHISH, personi që emërohet në detyrë pa konkurim, fiton statusin e punonjësit të SHISH dhe nëpërmjet aktit të emërimit vendoset njëkohësisht edhe marrëdhënia e punësimit midis tij dhe SHISH.

Në referim të nenit 13, pika 1, germa “e” dhe nenit 30, germa “c” të ligjit nr.9 357/2005, punonjësi i SHISH, pra personi në detyrë dhe që është në një marrëdhënie pune me SHISH (jo kursanti, që përgatitet në kurset e institutit të SHISH për t’u përë punonjës i SHISH), ka të drejtën dhe detyrimin që të trajnonhet, të kualifikohet dhe të rrisë aftësitë profesionale.

Organizimi i kurseve për përgatitjen informative e formimin bazë profesional, si dhe kurset e kualifikimit dhe të specializimit të punonjësve të SHISH-it, në funksion të sigurisë kombëtare, realizohet nga Instituti i Shërbimit Informativ të Shtetit (Instituti i SHISH-it) dhe rregullohen në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 1400, datë 17.10.2008 “*Për organizimin e kurseve në SHISH dhe trajtimin e pjesëmarrësve*”, të ndryshuar. Ndër të tjera, në VKM e sipërcituar, parashikohet: “1. *Në Institutin e Shërbimit Informativ të Shtetit (Instituti i SHISH-it) të organizohen kurse për përgatitjen informative e formimin bazë profesional, si dhe kurse të kualifikimit dhe të specializimit të punonjësve të SHISH-it, në funksion të sigurisë kombëtare. Lloji dhe kohëzgjatja e kurseve përcaktohen me urdhër të drejtorit të SHISH-it. 2. Kursantët e rinj, për inspektorë dhe ndihmësinsektorë, gjatë kohës, që ndjekin kursin, marrin pagën e nivelit bazë, për klasë pa shtesa mbi pagë, .....4. Kursanti, i cili përfundon kursin bazë të formimit profesional*

*dhe nuk paraqitet në detyrë pas emërimit, paguan të plota shpenzimet e bëra për trajnimin e tij. 5. Punonjësit, të cilët janë në marrëdhënie pune në SHISH ose në institucione analoge informative shqiptare dhe vazhdojnë kursin e përgatitjes e të formimit bazë profesional informativ, përfitojnë pagën mujore të funksionit organik, që kanë pasur para fillimit të kursit, dhe gjatë kursit nuk marrin dietë, por trajtohen me fjetje pa pagesë dhe me ushqim, në kuotën e përcaktuar nga drejtori i SHISH-it, deri në masën 800 lekë/dita për kursant.”*

Sa më sipër, rezulton se, kursi bazë i formimit profesional, parashikohet për kursantët e rinj inspektorë dhe ndihmës inspektorë dhe nga ana tjetër, kursi i përgatitjes së formimit bazë profesional informativ, ofrohet edhe për punonjësit të cilët janë në marrëdhënie pune në SHISH, pa bërë diferencime midis inspektorit dhe ndihmës inspektorit.

Referuar fakteve dhe rrethanave konkrete të çështjes objekt shqyrtimi, rezulton se, ankuesi E.A ka lidhur marrëdhënien e punës me SHISH me urdhrin nr.18-138, datë 21.05.2012, të Drejtorit të SHISH, pa konkurim, në pozicionin ndihmës inspektor, shofer. Për rrjedhojë, ankuesi e ka fituar statusin e punonjësit të SHISH që në momentin e emërimit të tij në detyrë në pozicionin ndihmës inspektor, shofer, me urdhrin e sipërcituar të Drejtorit të SHISH. Në vijim të marrëdhënies së tij të punës pranë SHISH, në datën 06.09.2013, ankuesi është miratuar për të ndjekur kursin bazë të formimit profesional në Shërbim, të cilin e ka përfunduar në datën 04.04.2014, në kuadër të detyrimeve dhe të drejtave që burojnë nga ligji për statusin e punonjësit të SHISH, për trajnimin dhe formimin profesional të punonjësve të SHISH.

Bazuar në kuadrin ligjor të sipërcituar si dhe referuar fakteve dhe rrethanave të çështjes, Komisioneri nuk konstaton asnjë detyrim ligjor për SHISH për ndryshimin e pozicionit të punës së ankuesit dhe emërimin e tij inspektor, me pretendimin e ai ka kryer kursin e formimit bazë informativ.

Në bazë të nenit 30, germa “a” të ligjit nr. 9357/2005, punonjësi i SHISH ka të drejtë të përparojë në karrierë. Mënyra e përparimit në karrierë e parashikuar nga ky ligj, realizohet nëpërmjet ngritjes në detyrë, parashikuar nga neni 10, në të cilin përcaktohet se: “1. Punonjësi i Shërbimit Informativ të Shtetit mund të ngrihet në detyrë kur vlerësohet me shkallën “shumë mirë”. 2. Punonjësi, që ka masë disiplinore të pashlyer, nuk mund të ngrihet në detyrë.”

Ankuesi i ka paraqitur kërkesat e tij për t’u emëruar inspektor jo si kërkesa për ngritje në detyrë, me pretendimin se, në përfundimin e kursit bazë të linjës operative, SHISH kishte detyrimin që të nxirrte një akt të ri emërimi dhe t’a sistemonte ankuesin në një pozicion të ri pune si inspektor, duke e konsideruar si “emërim fillestar” dhe jo “ngritje në detyrë”. Nga ana tjetër SHISH, i konsideron kërkesat e tij si kërkesa për ngritje në detyrë.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, SHISH nuk ka patur detyrim ligjor për të emëruar ankuesin në një pozicion të ri pune si inspektor. Në këto kushte, Komisioneri do të

vlerësojë nëse SHISH ka vlerësuar në mënyrë të bazuar kërkesat e ankuesit për t'u emëruar inspektor, në përputhje me kriteret ligjore të vendosura për ngritjen në detyrë.

Në bazë të vendimit Nr.432, datë 13.7.2007 *“Për klasifikimin e funksioneve, trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”*, të ndryshuar ndihmës inspektor i korrespondon një niveli më të ulët se inspetor, e cila shoqërohet me diferencë në pagë. Rrjedhimisht edhe emërimi nga ndihmës inspektor në inspektor për ankuesin i cili ishte punonjës efektiv i SHISH konsiderohet ngritje në detyrë.

Kërkesën e parë me shkrim për emërimin e tij si inspektor, pavarësisht cilësimit që i bën ankuesi kërkimit të tij (duke mos e konsideruar ngritje në detyrë, por emërim fillestar), ankuesi e ka paraqitur në datën 11.06.2018. Kjo kërkesë është refuzuar nga SHISH me arsyetimin e ankuesi nuk përmbushte kriteret e përcaktuara në nenin 10, të ligjit nr.9357/2005, pasi kishte vlerësimin e punës “mirë”. Bazuar në kriteret e vendosura nga neni 10, i ligjit nr.9357/2005, rezulton se punonjësi i SHISH mund të ngrihet në detyrë kur vlerësohet me shkallën “shumë mirë”. Referuar relacionit të datës 10.07.2018, të hartuar në lidhje me këtë kërkesë të paraqitur nga ankuesi, drejtoria përkatëse në SHISH relatton se, në zbatim të nenit 10, të ligjit nr.9357/2005, ankuesi nuk plotëson të gjitha kriteret për ngritje në detyrë, pasi vlerësimin për vitin 2017 e ka “mirë”. Nga ana tjetër, bazuar në parashtrimet e ankuesit, ky i fundit nuk pretendon se ka patur vlerësimin “shumë mirë” për periudhën e respektive.

Në datën 23.04.2019, ankuesi ka paraqitur një tjetër kërkesë me shkrim drejtuar Drejtorit të SHISH, në të cilën kërkon emërimin e tij si inspektor në një vend vakant të krijuar në një drejtori të SHISH. Edhe në këtë kërkesë, qasja e ankuesit në lidhje me emërimin e tij inspektor është e njëjtë me kërkesën e vitit 2018. Për trajtimin e kësaj kërkesë është hartuar relacioni i datës 13.05.2019, në të cilin drejtoria përkatëse është shprehur se, ankuesi nuk plotëson. Bazuar në parashtrimet e ankuesit, ky i fundit deklaroi se, vlerësimi i punës gjatë vitit 2018, ka qenë “mirë”, pra jo në nivelin “shumë mirë”, sikurse kërkohet nga neni 10, i ligjit nr.9357/2015, lidhur me ngritjen në detyrë.

Në kërkesën ankimore të datës 14.10.2019, një ndër pretendimet e ankuesit ka qenë edhe emërimi i tij inspektor. Lidhur me këtë kërkesë ankimore është hartuar relacioni i datës 15.10.2019, nga drejtoria përkatëse, drejtuar Drejtorit të SHISH, ku relatohet se, ankuesi nuk plotëson kriteret për ngritjen nga detyrë pasi nuk e ka vlerësimin e punës “shumë mirë” dhe ka masa disiplinore të pashlyera. Pretendimet e ankuesit në lidhje me masat disiplinore do të trajtohen në vijim, por gjatë kësaj periudhe, ankuesi ka patur një masë disiplinore në fuqi të dhënë në datën 25.07.2019.

Ankuesi ngre pretendimin se, vlerësimet e punës kanë qenë tendencioze dhe qëllimisht ai nuk është vlerësuar “shumë mirë”.

Sipas relacionit të datës 18.10.2019, të hartuar nga drejtoria që merret me administrimin e burimeve njerëzore, sugjerohet se, pretendimet e ankuesit në lidhje me vlerësimin e tij “jo

mjaftueshëm” të dhënë për 9 muajt e parë të vitit 2019, në vijim të transferimit të ankuesit në pozicionin ndihmës inspektor, roje, të konsiderohen të paraqitura brenda afatit 5 ditor të ankimit dhe të adresohen për shqyrtim në një njësinë përkatëse. Njësia e ngarkuar me verifikimin e procedurave të vlerësimit të ankuesit, ka konstatuar se drejtuesit e drejtorisë ku ka punuar ankuesi gjatë 9 muajve të parë të vitit 2019 kanë zbatuar të gjitha procedurat për vlerësimin e punës së ankuesit dhe kanë rekomanduar që vlerësimi i punës për periudhën janar-shtator 2019 të qendrojë në nivelin “jo mjaftueshëm”, fakt ky që rezultoi i provuar bazuar në raport vlerësimin me nr.84/3 datë 12.11.2019.

Sa më sipër rezultoi se, ankuesi nuk e ka patur vlerësimin e punës “shumë mirë” sipas kriterit të kërkuar nga neni 10 i ligjit nr.9357/2005, për ngritje në detyrë e për rrjedhojë ankuesi ka patur pengesë ligjore për emërimin si inspektor, në kushtet që konstatohet pozicioni i lirë pune, që i përket këtij niveli.

Në lidhje me pretendimet e ankuesit se vlerësimet e tij të punës kanë qenë tendencioze dhe të qëllimshme në mënyrë që të pengonin emërimin inspektor, Komisioneri i gjen ato të pabazuara në informacionin dhe provat e administruara. Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, rezultoi se, në rastet kur ankuesi ka ngritur pretendime në lidhje me vlerësimin e punës, SHISH i ka adresuar ankesat e tij dhe njësitet respektive në përbërje të SHISH kanë kryer verifikimet përkatëse. Në kushtet kur ankuesi ka ezauruar të drejtën e tij për të ankimuar vlerësimet e punës dhe strukturat përgjegjëse kanë kryer verifikimet përkatëse, Komisioneri nuk mund të vërë në dyshim punën dhe konkluzionet e arritura nga këto struktura të ligjshme, vetëm se vendimarrja e tyre nuk ka qenë në favor të ankuesit. Argumenti i parashtruar nga ankuesi se, personat në njësitet që kanë kryer kontrollin apo verifikimet e ankesave dhe pretendimeve të tij janë “shok” ose “miq” të eprorëve të tij, nuk është një argument i bazuar për të kundërshtuar ligjshmërinë e vlerësimeve të punës të kryera për ankuesin.

- **Në lidhje me pretendimet e ankuesit për masat disiplinore të marra ndaj tij deri në marrjen e masës disiplinore “përrjashtim nga Shërbimi”.**

Në lidhje me masat disiplinore “vërejtje me paralajmërim” të marrë në datën 29.05.2014 dhe “vërejtje me shkrim” të marrë në datën 29.08.2016, të cilat janë dhënë ndaj ankuesit gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së tij të punës pranë SHISH, Komisioneri vlerëson se ato janë tej çdo afati ligjor për tu marrë në shqyrtim nga Komisioneri.

Dhënia e masave disiplinore, llojet dhe procedura e dhënies së tyre deri në përjashtimin nga shërbimi të punonjësit të SHISH-it, rregullohet në Kreun V, të ligjit nr. 9357/2005, nenet 46 deri në 54. Disa nga këto dispozita ligjore kanë pësuar ndryshime me ligjin nr. 97, datë 23.07.2020, ndrysa referimi i tyre në këtë vendim është bërë sipas parashikimeve, që kanë qenë në fuqi në kohën që kanë ndodhur ngjarjet objekt i kësaj ankese.

Në nenin 46, të ligjit nr. 9357/2005, parashikohet: “1. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i jepet masë disiplinore për mosplotësimin e detyrave, për thyerje të disiplinës në punë dhe të rregullave të etikës, për shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, veprime që nuk përbëjnë vepër penale apo kundërvajtje penale, si dhe në rastet e tjera, të parashikuara nga ky ligj. 2. Masat disiplinore jepen sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t’u vënë në dijeni, për t’u dëgjuar, për t’u mbrojtur dhe për t’u ankuar. Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit miraton rregulloren e disiplinës, kërkesat e të cilës janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit”

Sipas nenit 47, të ligjit nr.9357/2015, llojet e masave disiplinore janë: a) vërejtje me shkrim; b) vërejtje me paralajmërim; c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në dy vjet; ç) kalim në një detyrë të një niveli ose klase më të ulët, për një periudhë deri në një vit; d) shkarkim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër, më të ulët; dh) përjashtim nga Shërbimi.

Në nenin 48, pika 1, të ligjit nr. 9357/2005 parashikohet se: “1. Fillimi i procedimit disiplinor për shkronjat “a” e “b”, të nenit 47 bëhet nga eprori direkt i punonjësit, ndërsa për shkronjat “c”, “ç”, “d” e “dh” të nenit 47, nga Drejtori i SHISH-it, mbështetur edhe në mendimet e njësisë së ngarkuar me funksionet e inspektimit”.

Në nenin 49, të ligjit nr.9357/2005 parashikohet se: “Me urdhër të Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit krijohet komisioni disiplinor për shqyrtimin e ankesave të punonjësve të këtij Shërbimi për masat disiplinore të përmendura në nenin 47. Në përfundim të shqyrtimit, komisioni disiplinor del me propozimet përkatëse para Drejtorit të Shërbimit, i cili vendos për marrjen, ndryshimin ose moszbatimin e masës.”

Në nenin 54, të ligjit nr. 9357/2005, parashikohet: “1. Shërbimi Informativ i Shtetit ndërpret marrëdhëniet e punës me punonjësin, duke e përjashtuar nga Shërbimi, kur dënohet me vendim të formës së prerë nga gjykata me heqje lirie për krimet e kryera me dashje. 2. Punonjësi i SHISH-it, ka të drejtë të ankohet, brenda 30 ditëve nga data e komunikimit të urdhrorit, te Drejtori, i cili, brenda 30 ditëve, është i detyruar të kthejë përgjigje. Në qoftë se nuk i kthehet përgjigje, atëherë ankuesi, brenda 30 ditëve, ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës”.

Në periudhën e pretenduar ka qenë në fuqi Rregullorja Nr.24-95, datë 03.06.2019 “Për disiplinën në Shërbimin Informativ të Shtetit”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHISH. (në vijim Rregullorja e Disiplinës)

Në nenin 7, pikat 1 e 2, të Rregullores së Disiplinës parashikohet: “1. Punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit i jepet masë disiplinore për shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, veprime që nuk përbëjnë vepër penale apo kundërvajtje penale, për mosplotësimin e detyrave, si dhe rastet e tjera, të parashikuara nga kuadri ligjor.2. Shkeljet disiplinore në SHISH karakterizohen në shkelje të lehta dhe të rënda. Për të bërë kategorizimin e shkeljes duhen marrë paraqysh lloji i

*shkeljes, rrethanat e kryerjes së veprimit ose mosveprimit, qëllimi, pasojat, shkallën e fajësisë, kontributi dhe vlerësimi i punës në SHISH të punonjësit etj.....”*

Në nenin 11, të Rregullores së Disiplinës, parashikohen llojet e masave disiplinore, të cilat mund të jepen ndaj një punonjësi të SHISH. Konkretisht në këtë nen parashikohet: *“1. Punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit i jepet masë disiplinore për shkeljet e përcaktuara në nenet e mësipërme, si më poshtë: a) vërejtje me shkrim; b) vërejtje me paralajmërim; c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në dy vjet; ç) kalim në një detyrë të një niveli ose klase më të ulët, për një periudhë deri në 1 vit; d) shkarkim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët;dh)përfundim nga Shërbimi. 2. Masat e mësipërme jepen në mënyrë të përshkallëzuar, në përputhje me llojin e shkeljes dhe të pasojave të saj.”*

Në nenin 12, pikat 1 e 2, të Rregullores së Disiplinës, parashikohet se: *“1. Masat disiplinore të gërbave “a” e “b” të pikës 1, të nenit 11, jepen për shkeljet e konsideruara të lehta, të cilat kanë si qëllim këshillimin dhe paralajmërimin e punonjësit.2.Masat disiplinore të gërmave “c”, “ç”, “d” e “dh” të pikës 1, të nenit 11, jepen për shkelje të konsideruara të rënda....”*

Në nenin 13, pika 4, të Rregullores së Disiplinës, parashikohet se: *“Punonjësi i SHISH-it përjashtohet nga shërbimi për shkelje më të randa disiplinore, pa qenë e nevojshme zbatimi sipas radhës i masave disiplinore të nenit 11, të kësaj rregulloreje”.*

Në nenin 15, të Rregullores së Disiplinës, parashikohet se: *“Dhënia e masave disiplinore për llojet e masave të përcaktuara në gërmat “a” e “b” të nenit 11, fillon me nismën e eprorit direkt të punonjësit, bazuar në informacionin me shkrim, të administruar prej tij apo drejtuar atij nga çdo strukturë tjetër e SHISH ose person i cënuar. 2. Propozimet për llojet e masave të përcaktuara në gërmat “c”, “ç”, “d” e “dh” të nenit 11, fillon nga informacioni i eprorit direkt të punonjësit apo informacion nga njësitet e tjera ose i ankesave me shkrim të paraqitura tek Drejtori i SHISH-it, në adresë të personit që do të procedohet për masë disiplinore”.*

Në nenin 21, të Rregullores së Disiplinës, parashikohet se: *“1. Punonjësi ndaj të cilit është marrë masa disiplinore, gëzon të drejtë ankimit. 2. Ankimi bëhet me shkrim brenda 15 ditëve nga data e komunikimit të masës disiplinore. 3. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Disiplinës..”*

Punonjësi ndaj të cilit është marrë masa disiplinore ka të drejtën të mbrohet. E drejta e mbrojtjes parashikohet në nenin 23, të Rregullores së Disiplinës, ku parashikohet: *“1 Çdo punonjës ndaj të cilit është marrë masë disiplinore ka të drejtë të njihet me materialin e procedimit disiplinor dhe të përgatitë mbrojtjen e tij para Komisionit Disiplinor, si dhe iu përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të Komisionit Disiplinor.....”.*

Në nenin 24, të Rregullores së Disiplinës, parashikohet se: *“1. Përbërja e Komisionit Disiplinor, në vijim Komisioni, përcaktohet me Urdhër të veçantë të Drejtorit të Shërbimit. 2. Shqyrtimi i ankesave për masat disiplinore të marra, bëhet nga Komisioni.....4. Komisioni Disiplinor, brenda*

*5 ditëve, nga dita e mbledhjes, përgatit raport me shkrim me propozimet përkatëse, mbi shkeljen e disiplinës së kryer nga punonjësi.5.Raporti i Komisionit i njoftohet punonjësit ankimues dhe Drejtorit të SHISH-it me shkrim.”*

Shqyrtimi përfundimtar i masës disiplinore bëhet nga Drejtori i SHISH-it. Në nenin 25, të Rregullores së Disiplinës, parashikohet: *“Drejtori i SHISH-it pas shqyrtimit të raportit të Komisionit, vendos për marrjen, ndryshimin ose moszbatimin e masës disiplinore. Vendimi përfundimtar i njoftohet me shkrim nga Komisioni punonjësit ankimues, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së tij. 2. Urdhri i masës disiplinore në fund të këtij procesi evidentohet në dosjen personale”.*

Rezulton se, me urdhrin nr. 520/3 prot., datë 25.07.2019, të drejtuesit të drejtorisë respektive në SHISH dhe njëkohësisht eprorit të ankuesit, ndaj këtij të fundit është dhënë masa disiplinore *“vërejtje me paralajmërim”* me motivacionin *“Shkeljen e rregullave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për ruajtjen e sekretit shtetëror në SHISH, kur nuk përbën vepër penale”.* Gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi se kjo masë disiplinore është dhënë pasi është konsideruar si shkelje fakti që ankuesi ka frekuentuar shtëpinë e pushimit në Himarë të SHISH, ambient ky që sipas SHISH nuk mund të frekuentohet nga struktura të veçanta të SHISH, sikurse struktura ku punonte ankuesi, në zbatim të ligjit nr .8391, datë 28.10.1998 *“Për Shërbimin Informativ Kombëtar”*, i ndryshuar. Bazuar në parashtrirat me shkrim dhe deklaratimet e bëra nga palët gjatë seancës dëgjimore, rezulton se fleta e kampit me të cilën ankuesi kishte aksesuar shtëpinë e pushimit në Himarë të SHISH ishte lëshuar në emrin e babait të ankuesit, i cili gjithashtu ishte punonjës në SHISH. Sipas SHISH, ky regjim rregullohet edhe nga aktet e brendshme nënligjore dhe rregullorja e brendshme e strukturës ku ankuesi punonte, por dokumentet që lidhen me këtë rast janë përjashtuar nga deklasifikimi me vendimin nr. 9/1, datë 02.11.2021 të KDZH. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e SHISH parashtruan se, rregullorja e brendshme e funksionimit të njësisë ku ankuesi punonte, e cila është përjashtuar nga deklasifikimi në bazë të vendimit të KDZH, ka të specifikuar shprehimisht detyrimin për mosekspozimin e punonjësve. Pra punonjësit e kësaj njësie nuk mund të paraqiten as pranë aparatit qendër të SHISH.

Duke e pretenduar masën disiplinore të padrejtë dhe të pabazuar, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionit të Disiplinës. Ankuesi pretendon se, shkelja e pretenduar nuk parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat pretendohen se janë shkelur nga ana e SHISH.

Rezulton se ankuesi është thirrur nga Komisioni Disiplinor për t’u dëgjuar dhe për t’u pyetur në lidhje me ankimin e paraqitur. Në përfundim të shqyrtimit Komisioni i Disiplinës me vendimin nr. 37/4, datë 15.08.2019, ka lënë në fuqi masën disiplinore *“vërejtje me paralajmërim”* dhe i ka përcjellë Drejtorit të SHISH propozimin e tij. Në datën 28.08.2019, Drejtori i SHISH ka lënë në fuqi propozimin e Komisionit të Disiplinës.

Komisioneri gjykon se, bazuar në provat e administruara, nuk mund të vlerësojë interpretimin që i behet akteve të brendshme të SHISH, sikurse është rregullorja e brendshme e strukturës në të cilën

ankuesi ka punuar, për më tepër në kushtet kur nuk është administruar një kopje e kësaj rregulloreje për shkak se është përjashtuar nga procesi i deklasifikimit.

Komisioneri konstaton se, shkelja për të cilën është dhënë masa disiplinore ndaj ankuesit *“Shkeljen e rregullave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore për ruajtjen e sekretit shtetëror në SHISH, kur nuk përbën vepër penale”*, referuar Rregullores së Disiplinës, klasifikohet si shkelje e rëndë, sipas pikës 6, të nenit 9 të saj. Rrjedhimisht, bazuar në nenin 11, pika 1 dhe 12, pikat 1 e 2, të Rregullores së Disiplinës, për këtë shkelje e cila konsiderohet si shkelje e rëndë, duhet të ishte dhënë një nga masat disiplinore të parashikuara nga pikat “c”, “ç”, “d” ose “dh”, të nenit 11, pika 1, ndërsa ndaj ankuesit është dhënë masa disiplinore *“vërejtje me paralajmërim”*, parashikuar nga germa “b” e nenit 11, pika 1 të rregullores. Masa disiplinore e dhënë ndaj ankuesit *“vërejtje me paralajmërim”*, referuar pikës 1, të nenit 12, jepet për shkelje që konsiderohen të lehta.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimeve të mësipërme të cilat vlerësohen se nuk janë marrë në përputhje me parashikimet e Rregullores së Disiplinës, në lidhje me klasifikimin e llojit të masës disiplinore në raport me llojin e shkeljes së konstatuar, pozita e ankuesit nuk është rënduar, pasi ndaj ankuesit është dhënë masa disiplinore *“vërejtje me paralajmërim”* e cila ka si qëllim këshillimin dhe paralajmërimin e ankuesit. Ndërkohë që ndaj ankuesit për shkeljen e konstatuar dhe të konsideruar si shkelje e rëndë, duhet të ishte marrë një masë disiplinore më e rëndë, parashikuar nga 11, pika 1, germa “c” - *“pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në dy vjet”*, germa “ç” - *“kalim në një detyrë të një niveli ose klase më të ulët, për një periudhë deri në 1 vit”*, germa “d” - *shkarkim nga detyra dhe kalim në një detyrë tjetër më të ulët”* ose germa “dh” - *“përjashtim nga Shërbimi”* .

Me urdhrin nr.25-536, datë 30.09.2019,të Drejtorit të SHISH, ankuesi është liruar nga detyra që mbante dhe është emëruar ndihmës inspektor, roje, në një njësi tjetër të SHISH. Ankuesi pretendon se, ndryshimi i vendit të punës përbën një tjetër masë disiplinore ndaj tij, pasi ai është emëruar në një detyrë më të ulët, e cila shoqërohet edhe me ulje në pagë. Ankuesi pretendoi se, kalimi i tij në detyrën e re kishte ndodhur si pasojë e ankimit administrative që ai kishte bërë pranë Drejtorit të SHISH. SHISH, prapësoi këtë pretendim të ankuesit duke deklaruar se, emërimi i ankuesit në një detyrë tjetër nuk ishte marrë në kuadër të ndonjë procedimi disiplinor, por kishte ndodhur për shkak të nevojave të punës, në kushtet kur që prej fillimit të punës në SHISH ankuesi kishte kryer disa shkelje si dhe bazuar në rekomandimet e dhëna nga njësia që kishte kryer kontrollin në vijim të kundërshtimit administrative që ankuesi kishte paraqitur lidhur me marrjen e masës disiplinore *“vërejtje me paralajmërim”*.

Nga aktet e administruara rezulton se, me kërkesën nr. 75/1 prot., datë 02.09.2019, ankuesi i është drejtuar Drejtorit të SHISH, duke kundërshtuar arsyen dhe mënyrën e dhënies së masës disiplinore. Drejtori i SHISH e ka adresuar ankimin për trajtim tek një njësi tjetër në SHISH. Bazuar në raportin e vlerësimit nr. 75/6 prot., datë 25.09.2019 *“Mbi kundërshtimin administrativ të përcjellë nga punonjësi E.A me detyrë inspektor”* njësia e ngarkuar me kontrollin e procedurave të ndjekura për dhënien e masës disiplinore nga njësia ku punonte ankuesi, nuk ka konstatuar shkelje nga



njësia e cila ka dhënë masën disiplinore nr. 520/3, datë 25.07.2019. Kjo njësi, i ka rekomanduar Drejtorit të SHISH që ankuesi të transferohej në një detyrë tjetër, jashtë njësive të veprimtarisë informative. Bazuar në këtë rekomandim, Drejtori i SHISH ka shkarkuar ankuesin nga detyra që mbante duke e emëruar ndihmës inspektor, roje.

Komisioneri konstaton se, ankuesi është emëruar brenda të njëjtit nivel që ishte, pra si ndihmës inspektor. Në lidhje me pretendimet për diferencë në pagë (pagë më të ulët) në detyrën e re, ankuesi nuk paraqiti asnjë provë në lidhje me këtë pretendim, ndërkohë që Komisioneri vlerëson se të dhënat në lidhje me pagën e përfituar në pozicionin e mëparshëm dhe atë të kundërshtuar prej tij, ankuesi ka patur të gjithë mundësinë që ta paraqiste.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 9357/2005, parashikohet se: *“1.Transferimi i punonjësit mund të bëhet nga Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit, vetëm për nevoja dhe në interes të punës. 2. Transferimi, si rregull, bëhet me pëlqimin e punonjësit.....4. Punonjësi, që nuk pranon të transferohet mund të ankohet te Drejtori i Shërbimit, i cili, brenda 30 ditëve, shqyrton ankesën dhe shprehet përfundimisht.”*

Ligji që rregullon statusin e punonjësit të SHISH, parashikon mundësinë e transferimit për nevoja dhe në interes të punës. Bazuar në raportin e vlerësimit nr.75/6, datë 25.09.2019, është rekomanduar që ankuesi të sistemohet në një tjetër detyrë jashtë njësive informative. Në këtë kontekst, rezulton se, SHISH ka vlerësuar se, për nevoja dhe në interes të punës, ankuesi duhet të vazhdonte marrëdhëniet e punës në një pozicion pune jashtë njësive informative. Kjo nevojë, nuk vjen e pambështetur, për sa kohë rezulton se, masa disiplinore nr. 520/3, datë 25.07.2019 *“vërejtje me paralajmërim”* e marrë ndaj ankuesit ka të bëjë me shkeljen e rregullave për ruajtjen e sekretit shtetëror në SHISH.

Kalimi i ankuesit në detyrën e re si ndihmës inspektor roje, nuk është realizuar me pëlqimin e ankuesit. Ankuesi deklaroi se urdhri për kalimin në detyrën e re si ndihmës inspektor roje, i është komunikuar në datën 30.09.2019. Në datën 14.10.2019, ankuesi ka paraqitur një kërkesë ankimore drejtuar Drejtorit të SHISH, nëpërmjet të cilës kundërshtoi emërimin e tij në detyrën e re si ndihmës inspektor roje. Për trajtimin e kësaj ankesë është hartuar relacioni i datës 15.10.2019. Në këtë relacion që i drejtohet Drejtorit të SHISH, raportohet ndër të tjera se, pretendimi i ankuesit se lëvizja e tij është bërë pas ankesës së tij për masë disiplinore dhe korrespondon me një masë disiplinore më të rëndë, nuk qëndron, pasi lëvizja e ankuesit nuk ka lidhje me vërejtjen, por me problematikat dhe çështjet konfliktuale. Më tej në relacion raportohet se, pozicioni i vetëm i mundshëm i lirë për ta sistemuar ka qenë pozicioni n/inspektor (roje).

Ankuesi e ka pranuar emërimin e ri si ndihmës inspektor roje dhe ka vazhduar marrëdhëniet e punës me SHISH.

Sa më sipër, nuk rezulton që emërimi i ankuesit në detyrën e re ndihmës inspektor roje, të jetë pasojë e një procesi disiplinor ose masë disiplinore e marrë ndaj ankuesit.

Pas marrjes së detyrës së re si ndihmës inspektor roje, në një tjetër njësi në SHISH, ndaj ankuesit është marrë masa disiplinore nr. 414/1 prot., datë 22.11.2019 “*vërejtje me shkrim*”, e cila është dhënë nga drejtuesi i njësisë. Motivacioni për dhënien e kësaj mase disiplinore është “*Për shkelje të disiplinës formale në punë lidhur me mosrespektimin e Manualit të Shërbimit*”.

Shkeljet mbi bazën e të cilave është dhënë masa disiplinore ndaj ankuesit, pasqyrohen në shkresën nr. 414 prot., datë 22.11.2019 me lëndë “*Informacion mbi dhënie mase disiplinore për n/inspektor (roje) E.A*”. Referuar shkresës së sipërcituar rezulton se nga data 23.10.2019 deri në datë 22.11.2019, ankuesi ka shfaqur mangësi të ndryshme në kryerjen e shërbimit dhe i është tërhequr disa herë vëmendja nga eprorët, konkretisht: në datën 23.10.2019, ankuesit i është tërhequr vëmendja për mospatrullim dhe mosraportim; në datë 25.10.2019 inspektori, nuk ka pranuar marrjen e shërbimit të rojes nga ankuesi për shkak të uniformës jo korrekte duke i tërhequr vëmendjen; në datën 04.11.2019, ankuesit i është tërhequr vëmendja për moszbatim të rregullave gjatë kryerjes së shërbimit; në datën 08.11.2019, ankuesit i është tërhequr vëmendja për qëndrim jo korrekt në vendroje dhe mospatrullim gjatë kryerjes së shërbimit; në datën 16.11.2019 ankuesit i është tërhequr vëmendja për uniformë jo të rregullt; dhe në datë 22.11.2019, është konstatuar se ankuesi nuk është paraqitur të marrë shërbimin e rojes.

Sipas ankuesit, shkeljet e pretenduara nga SHISH nuk janë të bazuara. Ankuesi pretendon se, është penalizuar me masë disiplinore për mungesën e këmishës së bardhë, ndërkohë që nga ana e SHISH nuk i është vendosur në dispozicion uniforma që kërkohet për pozicionin e tij të punës, ndërsa thekson se, nuk i është tërhequr asnjëherë vëmendja nga ana e eprorëve për shkeljet e pretenduara. Në lidhje me pretendimin se ishte larguar nga shërbimi, ankuesi deklaron se është larguar pasi është pezulluar nga vetë eprorët me pretendimin se nuk kishte uniformën e rregullt (nuk kishte veshur këmishë të bardhë). Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi deklaroi se ditën që ishte konstatuar se ishte me uniformë jo të rregullt ai kishte të njëjtën veshje që mbante veshur ditën e seances dëgjimore. Komisioneri, evidenton se, ditën e seancës dëgjimore ankuesi mbante veshur, kostum të zi, këmishë të zezë dhe kravatë me ngjyrat dhe simbolet e flamurit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

SHISH prapësoi pretendimet e ankuesit duke parashtruar se, masa disiplinore nuk ishte dhënë vetëm për uniformën jo të rregullt, por edhe për shkeljet e tjera në lidhje me kryerjen e shërbimit, të cilat gjejnë pasqyrim në dokumentacionet përkatëse. Në lidhje me këtë pretendim, përfaqësuesit e SHISH sqaruan gjatë seancës dëgjimore se, struktura ku punonte ankuesi kishte detyrimin që të mbante një uniformë të veçantë gjatë ushtrimit të detyrës me qëllim identifikimin e tyre. Në bazë të VKM Nr.140, datë 20.3.2019 “*Për miratimin e paraqitjes, të formës dhe të shenjave dalluese të uniformës, në njësi të veçanta të Shërbimit Informativ të Shtetit*”, janë miratuar paraqitja, forma dhe specifikimet teknike të uniformës së shërbimit, të cilat, sipas përfaqësuesve të SHISH nuk ishin bërë efektive për shkak të kohës së nevojshme për kryerjen e procedurave të prokurimi dhe kohës së nevojshme për përgatitjen e tyre për të gjithë punonjësit. Pavarësisht se nuk ka qenë e zbatueshme për momentin, kjo nuk e zhbën detyrimin për vendosjen dhe respektimin e një kodi

veshje. Në lidhje me këtë, SHISH theksoi se, detyrimi në lidhje me kodin e veshjes, buron edhe nga rregullorja e etikës së institucionit dhe ankuesi nuk e kishte respektuar atë me veshjen e tij gjatë kryerjes së shërbimit.

Duke mos qenë dakort me masën disiplinore “vërejtje me shkrim” ankuesi e ka kundërshtuar atë pranë Komisionit Disiplinor me anë të kërkesës ankimore nr.42 prot., datë 11.12.2019.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar ankimin duke i dhënë mundësinë ankuesit që të dëgjohej dhe të mbrohej. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni Disiplinor me vendimin nr. 42/4, datë 19.12.2019, ka vendosur t’i propozojë Drejtorit të SHISH dhënien e masës disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*”, pasi masa e dhënë ishte konform akteve në fuqi, por ankuesi kishte masë disiplinore të mëparshme ende të pashlyer. Me urdhrin nr. 25-627, datë 30.12.2019 të Drejtorit të SHISH “*Për ndryshimin e masës disiplinore të dhënë me urdhrin nr.414/1 datë 22.11.2019 dhe dhënien e masës disiplinore “Përrjashtim nga Shërbimi*”, është vendosur që të ndryshohet masa disiplinore nga “vërejtje me shkrim” në masën disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*” me motivacionin “*Për shkelje të detyrave të përcaktuara në ligjin nr.9357, datë 17.03.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit*”. Më anë të këtij urdhri, të drejtat administrative dhe financiare me ankuesin janë ndërprerë në datën 30.12.2019.

Komisioneri vlerëson se, në rastet kur masa disiplinore ankimohet nga punonjësi në Komisionin e Disiplinës, Drejtori i SHISH, në bazë të nenit 49 të ligjit nr.9357/2005 dhe nenit 25, të Rregullores së Disiplinës ka autoritetin dhe kompetencën që të vendosë për marrjen, ndryshimin ose moszbatimin e masës disiplinore. Bazuar në këtë kompetencë ligjore, Drejtori i SHISH ka vendosur të ndryshojë masën disiplinore “vërejtje me shkrim” të dhënë drejtuesi i njësisë ku punonte ankuesi duke urdhëruar marrjen e masës disiplinore “përrashtim nga shërbimi”.

Komisioneri konstaton se masa disiplinore “*përrjashtimi nga shërbimi*” është një masë disiplinore e parashikuar nga neni 47 i ligjit nr.9357/2005 dhe Rregullorja e Disiplinës në nenin 11. Ndërsa, “*Përrjashtimi nga Shërbimi*”, sipas parashikimit të nenit 54, të ligjit nr.9357/2005, nuk përbën masë disiplinore që merret ndaj punonjësit të SHISH, në kuadër të një procedimi disiplinor, por një detyrim ligjor për SHISH, për të urdhëruar përrjashtimin nga shërbimi të punonjësit të SHISH, i cili është dënuar me heqje lirie me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, përrjashtimi nga shërbimi i ankuesit ka ardhur si pasojë e marrjes ndaj tij të masës disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*”, parashikuar nga neni 47/dh të ligjit nr. 9357/2005, në përfundim të procesit disiplinor, dhe jo në referencë të nenit 54, të ligjit nr. 9357/2005.

Ankuesi pretendoi se, ndaj tij është marrë një masë e rëndë disiplinore ajo e “përrjashtimit nga shërbimi” jo në raport me llojin e shkeljes, ndërkohë që masat disiplinore duhet të jepen në mënyrë të shkallëzuar, në përputhje me llojin e shkeljes.

Bazuar në aktet e administruara rezulton se, gjatë shqyrtimit të ankimit të paraqitur nga ankuesi kundër masës disiplinore përpara Komisionit të Disiplinës, ky i fundit ka ndryshuar klasifikimin e shkeljeve të konstatuara, jo më si shkelje të lehta, por si shkelje të rënda për shkak se janë kryer në mënyrë të përsëritur nga ankuesi dhe se ky i fundit kishte masë disiplinore në fuqi ende të pashlyer. Në vijim, të propozimit të Komisionit të Disiplinës, Drejtori i SHISH, ka vendosur bazuar në kompetencën e tij, të ndryshojë masën disiplinore nga “*vërejtje me shkrim*” dhënë me motivacionin “*Për shkelje të disiplinës formale në punë lidhur me mosrespektimin e Manualit të Shërbimit*” në masën disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*” bazuar në motivacionin “*Për shkelje të detyrave të përcaktuara në ligjin nr.9357, datë 17.03.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”*”.

Shkelja e detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 9357, datë 17.03.2005 “*Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit*”, për të cilën është dhënë masa disiplinore “*përrjashtim nga shërbimi*” referuar nenit 9, të Rregullores së Disiplinës, klasifikohet si shkelje e rëndë. Rregullorja e Disiplinës, në nenin 13, pika 4, lejon shmangien nga respektimi i dhënies në mënyrë të përshkallëzuar dhe respektimi i radhës në dhënien e masave disiplinore të parashikuara nga neni 11, i kësaj rregulloreje. Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimi i ankuesit nuk është i bazuar.

Rezulton se, pasi ankuesi është njohur me propozimin e Komisionit të Disiplinës, ka paraqitur kundërshtimin administrativ datë 27.12.2019, nëpërmjet të cilit kundërshton propozimin e bërë nga Komisioni i Disiplinës. Ndryshe nga sa pretendon ankuesi, se Komisioni Disiplinor ka propozuar lirim nga detyra, nga aktet e administruara, rezulton se ky komision i ka propozuar Drejtorit të SHISH, përrjashtimin nga shërbimi të ankuesit dhe jo lirim nga shërbimi.

Referuar nenit 45, të ligjit nr.9357/2005, lrimi nga shërbimi i punonjësit të SHISH, nuk është pasojë e procesit disiplinor dhe dhënies së masës disiplinore. Lrimi nga shërbimi është i lidhur me arsye dhe motive të tjera sipas parashikimit në nenin e sipërcituar, që nuk lidhen me konsumimin e shkeljeve disiplinore nga ana e punonjësit.

SHISH, i ka kthyer përgjigje ankimit administrativ të datës 27.12.2019, të paraqitur nga ankuesi kundër propozimit të Komisionit Disiplinor me anë të shkresës nr.1865 prot., datë 31.12.2019, ndërsa masa disiplinore “përrjashtim nga shërbimi” ishte marrë me urdhrin e Drejtorit të SHISH në datën 30.12.2019. SHISH e konsideron të pambështetur kundërshtimin administrativ kundër propozimit të Komisionit Disiplinor, pasi nuk gjen mbështetje ligjore dhe ankuesi i kishte shteruar të gjitha hallkat e ankimit të parashikura në ligjin për statusin e punonjësit të shërbimit.

Marrëdhënia midis ankuesit dhe SHISH është një marrëdhënie pune e cila rregullohet në bazë të një ligji të posaçëm që është ligji nr. 9357/2005. Ky ligj dhe Rregullorja e Disiplinës e miratuar nga Drejtori i SHISH, nuk parashikon ndonjë të drejtë ankimi kundër propozimit të Komisionit Disiplinor. Në kushtet kur, autoriteti përfundimtar për të marrë masën disiplinore është Drejtori i SHISH, Komisioneri vlerëson se në thelb “propozimi” i Komisionit të Disiplinës nuk është një akt që cënon ankuesin, pasi nuk është një akt me karakter detyrues dhe që sjell pasoja, pasi është Drejtori i SHISH ai që vendos për marrjen, ndryshimin ose moszbatimin e masës disiplinore ndaj punonjësit që e ka ankimuar.

Ankuesi pretendon se, Komisioni Disiplinor nuk ka shqyrtuar në mënyrë objektive ankesat e tij. Sipas ankuesit një gjë e tillë ka ndodhur për shkak se anëtarë të Komisionit të Disiplinës janë emëruar nga drejtori aktual dhe ish drejtori z. Visho Ajazi Lika dhe kronologjia e ngjarjeve dhe rënia ndesh me të vërtetën bën të dyshosh se qëndrimet e tyre të verbra mund të jenë udhëzuar nga më lart. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi insistoi në faktin se anëtarët e Komisionit të Disiplinës nuk mund të dilnin ndesh në kushtet kur masat disiplinore ose problematikat e ankuesit përfshinin persona të cilët ishin “miqtë” e tyre. Komisioneri i gjen këto pretendime të ankuesit të pabazuara. Komisioni i Disiplinës është një organ i cili parashikohet nga ligji nr.9357/2005 dhe rregullohet në mënyrë më të hollësishme nga Rregullorja e Disiplinës. Komisioni Disiplinor në bazë të Rregullores së Disiplinës, neni 24/1, përcaktohet me urdhër të veçantë të Drejtorit të SHISH. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e SHISH sqaroi se, përbërja e komisionit është në bazë të funksioneve dhe jo në bazë të emrave të punonjësve konkretë dhe anëtarë të Komisionit të Disiplinës janë drejtues të njësive kryesore të SHISH.

Komisioneri nuk mund të vërë në dyshim veprimtarinë e Komisionit të Disiplinës, propozimet e të cilit nuk kanë qenë në favor të ankuesit, duke u bazuar në argumentet e mësipërme të parashtruara nga ankuesi, të cilat nuk mund të përbëjnë agrumenta ligjorë.

Komisioneri konstaton se, problematikat e ankuesit shtrihen në një periudhë të gjatë kohore dhe kanë ndodhur në struktura dhe njësi të ndryshme të SHISH ku ankuesi ka punuar. Bazuar në aktet e administruara, rezulton se, SHISH ka marrë në shqyrtim dhe ka trajtuar me kujdesin e duhur, ankesat dhe pretendimet e parashtruara nga ankuesi. Shqyrtimi i ankesave dhe verifikimi i problematikave të parashtruara nga ankuesi është realizuar nga punonjës dhe struktura të ndryshme në SHISH, të cilat i kanë gjetur të pabazuara pretendimet e ankuesit.

Komisioneri arrin në konkluzionin se ankuesi E.A nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e SHISH. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese për shkaqet e pretenduara nga ankuesi dhe rrjedhimisht nuk konstatohen shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit E.A, për të gjitha shkaqet e pretenduara prej tij, nga ana e Shërbimit Informativ Shtetëror.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Shkaku: “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore”, “përkatësisë prindërore”, “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”.

Fusha: Punësim

Lloji i vendimit: Mosdiskriminim